



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 735 Akti

Nr. 814 Vendimi  
Tiranë, më 14.11.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Olsi Komici</b>	Kryesues
<b>Brunilda Bektoshi</b>	Relatore
<b>Suela Zhegu</b>	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 14.11.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Spartak Mitrushi**, me detyrë ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998”, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneres Brunilda Bekteshi, si dhe mori në shqyrtim dhe analizoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES**

**1.** Z. Spartak Mitrush, me detyrë ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, referuar pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).

**2.** Referuar neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK, ish-Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar); Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

**3.** Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni ka zhvilluar shortin në datën 15.6.2021, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit, z. Spartak Mitrush, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Suela Zhegu, Brunilda Bekteshi dhe Olsi Komici. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Brunilda Bekteshi.

**4.** Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 21.6.2021, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Spartak Mitrush, si dhe caktoi kryesues të trupit gjykues komisionerin Olsi Komici. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

**5.** Subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur lidhur me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, sipas kërkesës së Komisionit, në datën 9.7.2021 ka deklaruar mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

**6.** Në datën 30.10.2024, Komisioni me vendimin nr. 2 vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Spartak Mitrush, për të tria kriteret e rivlerësimit, vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe të paraqesë pretendimet e tij brenda datës 11.11.2024 nga marrja e njoftimit me postë elektronike, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

**7.** Në datën 30.10.2024, subjekti i rivlerësimit u njoftua lidhur me: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të sjellë prova për të provuar

të kundërtën e konstatimeve të Komisionit. Në datën 11.11.2024, subjekti dërgoi në rrugë elektronike shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ.

8. Në datën 11.11.2024, trupi gjykues me vendimin nr. 3 vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Spartak Mitrush, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më 14.11.2024, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

9. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Spartak Mitrush, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

10. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Spartak Mitrush. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 11.11.2024, për të rifilluar po në të njëjtën datë për shpalljen e vendimit në orën 11:45.

## **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

11. Z. Spartak Mitrush ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur, kur i është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

## **III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI**

12. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

13. Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit nr. 2/20171 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

14. Subjekti i rivlerësimit, z. Spartak Mitrush, ushtron funksionin e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit që prej muajit qershor të vitit 2015 dhe aktualisht.

## **A. RIVLERËSIMI I PASURISË**

### **A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

**15.** ILDKPKI-ja ka kryer një kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim ka konstatuar se për subjektin e rivlerësimit, z. Spartak Mitrusi:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

## **A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

**16.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, konkretisht: (i) raportin e ardhur nga ILDKPKI-ja dhe dosjen për vlerësimin e pasurisë; (ii) deklaratën *Vetting* të dorëzuar nga subjekti pranë ILDKPKI-së, sipas ligjit nr. 84/2016 dhe ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003; (iii) dokumentet e ndodhura në dosjen e dërguar nga ILDKPKI-ja; (iv) dokumentacionin e administruar nga institucionet publike dhe private sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) deklaratimet e subjektit dhe provat e dërguara në përgjigje të pyetësorëve; (vi) raportin e administruar nga AKSIK-ja për kontrollin e figurës; (vii) formularin e plotësuar të kontrollit të figurës; (viii) hetimin administrativ të Komisionit; (ix) raportin profesional të administruar nga KLGJ-ja, për vlerësimin profesional; (x) dokumentet e ndodhura në dosjen e dërguar nga KLGJ-ja.

**17.** Mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, sipas formularit (shtojca nr. 2) datë 27.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë deklaruar në deklaratën *Vetting* pasuritë si vijon:

**18. Apartament banimi me sipërfaqe 107 m<sup>2</sup>** (93 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi + 14 m<sup>2</sup> ambient i përbashkët), rruga “\*\*\*”, blerë me kontratë sipërmarrjeje datë 12.9.2006 (i pahipotekuar). Vlera 75.000 euro. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: Kredi në Societe Generale Bank (ish-Banka Popullore) në shumën 35.000 euro sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 6.10.2006, nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz” në shumën 1.500.000 lekë dhe kursime të familjes. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente<sup>1</sup>.

**18.1** ILDKPKI-ja në raportin e tij ka konstatuar: mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, si mandatpagesa/arkëtime lidhur me pagesat e kryera në shumën totale 75.000 euro për apartamentin me sip. 107 m<sup>2</sup>, Tiranë; mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për pagesën e këstit të parë në shumën 40.000 euro, pasi kjo shumë është paguar në momentin e lidhjes së kontratës, ndërsa kredia është lëvruar më vonë.

---

<sup>1</sup> Kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë “I” sh.p.k., datë 12.9.2006, për porositjen e apartamentit me sipërfaqe gjithsej 107 m<sup>2</sup>, me çmim 75.000 euro. Lidhur me mënyrën e pagesës, kontrata citon: “Kësti i parë 40.000 euro është likuiduar me nënshkrimin e kontratës, diferenca do të likuidohet deri në marrjen e çelësve në dorë. Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 26.3.2008, për shitje automjeti tip “Mercedes-Benz”, me targë \*\*\*, palë shitëse shtetasin Spartak Mitrusi dhe blerës shoqërinë “H” sh.p.k., me vlerë 1.500.000 lekë” (Aneks nr. 4/2, administruar në dosjen e ILDKPKI-së).

## Hetimi i Komisionit

**18.2** Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës (si titullar i shërbimit të provës në Zyrën Vendore F) në vitin 2013. Në rubrikën “Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit”, subjekti ka deklaruar: “*Apartament me sipërfaqe 107 m<sup>2</sup>, rruga “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: kredi nga SGAL 35.000 euro. Shitje automjeti tip “Mercedes-Benz” 1.500.000 lekë. Kursimet e familjes”.*

**18.3** ZQRPP-ja<sup>2</sup> ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Tiranë, në të cilën rezulton se shtetasit Spartak Mitrushi dhe K.M nuk kanë pasuri të paluajtshme, apartament të regjistruar në emër të tyre.

**18.4** Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së Tiranë pas kërkesës<sup>3</sup> së Komisionit ka informuar<sup>4</sup> se shtetasi Spartak G Mitrushi rezulton i pajisur me vendim legalizimi nr. \*\*\*1, datë 18.6.2020.

**18.4.1** ASHK Drejtoria Vendore Tirana \*\*\* me informacionin e saj<sup>5</sup> ka bashkëlidhur disa dokumente<sup>6</sup>. Nga informacioni i dërguar rezulton se:

*i. Në emër të shtetasve Spartak G. Mitrushi dhe K.F.M rezulton pasuria me nr. \*\*\*, vol.\*\*\*, fq.\*\*\*, z. k. \*\*\*, e llojit apartament, me sipërfaqe totale 87.2 m<sup>2</sup>. Në shkresë cilësohet se pas verifikimit të kryer në arkivin e kësaj drejtorie referenca e kësaj pasurie rezulton në mungesë.*

*ii. Nga verifikimet e kryera në bazën digjitale të vetëdeklarimeve dhe arkivin pranë Drejtorisë Vendore Tirana \*\*\*, për sa i përket sektorit të legalizimeve, çështjeve të pronësisë dhe proceseve hartografike, rezulton se në emër të shtetasve Spartak G. Mitrushi dhe K.F.M është emetuar leje legalizimi nr. \*\*\*, datë 18.6.2020, për objektin “Shtesë kati - 1 kat në objekt ekzistues shtatë kate + dy kate nën tokë”, me adresë Njësia Administrative Nr. \*\*\*, Tiranë.*

**18.4.2** Komisioni, pas verifikimit të dokumentacionit të përcjellë nga Drejtoria Vendore Tirana \*\*\*, konstatoi disa mospërputhje, sikurse pasqyrohet në vijim:

**a.** Në datën 9.10.2017, subjekti i rivlerësimit i është drejtuar me kërkesë për t’u përfshirë në procesin e legalizimit Drejtorisë së ALUIZNI-t Tirana \*\*\*. Në kërkesë është shënuar adresa e objektit për legalizim: rruga “\*\*\*\*”, Njësia Bashkiake Nr. \*\*\*, Tiranë. Shkresa informuese mbi taksën e infrastrukturës të ASHK-së Drejtoria Tirana \*\*\*, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë, si dhe mandatpagesa e kryer në Raiffeisen Bank

<sup>2</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.2.2018, ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Tiranë nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2018, e cila konfirmon se Spartak Mitrushi dhe K.M nuk kanë pasuri të paluajtshme, apartament të regjistruar në emër të tyre (Aneks nr. 29, administruar në dosjen e ILDKPKI-së).

<sup>3</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.6.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>4</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.7.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>5</sup> Përcjellë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.8.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>6</sup> Leje legalizimi nr. \*\*\*, datë 18.6.2020, planimetri e katit të shtatë, Genplan, kontratë e sipërmarrjes datë 12.9.2006, kërkesë e subjektit të rivlerësimit drejtuar Drejtorisë së ALUIZNI-t Tirana \*\*\* për përfshirjen në procedurat e legalizimit për apartamentin objekt hetimi, pagesën e kryer të taksës vendore në vlerën 15.951,90 lekë në Raiffeisen Bank, me përshkrimin “Taksë vendore e ndikimit të Njesisë Bashkiake Nr. \*\*\*, Tiranë”; shkresë informuese të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës/Drejtoria Tirana \*\*\* nr. \*\*\* prot., datë 28.5.2020, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia T; njoftim i Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia T, drejtuar shtetasve Spartak dhe K.M mbi detyrimet për taksat vendore; planimetrinë e katit të gjashtë; foto të objektit të ndërtuar; kartelë të pasurisë së paluajtshme zona kadastrale\*\*\*, nr. pasurie \*\*\*, sipërfaqe totale 87.2 m<sup>2</sup>.

nga subjekti i rivlerësimit për taksën vendore për ndërtimet informale, kanë të njëjtën adresë të objektit, por ndryshon Njësia Bashkiake, nga nr. \*\*\* në nr. \*\*\*. Subjekti<sup>7</sup> lidhur me këtë mospërputhje ka konfirmuar se pas interesimit të tij pranë Njesisë Administrative nr. \*\*\* dhe Nr. \*\*\*, ka marrë dijeni se pallati (apartamenti) në të cilin banon është pjesë e Njesisë Administrative Nr.\*\*\* dhe ka bashkëlidhur dokumentet përkatëse<sup>8</sup> nga këto dy njësi administrative (bashkiake). Subjekti ka sqaruar se sipas hartës pallati ku banon është ndërtesa nr. \*\*\*, e shënuar me ngjyrë të kuqe, ku vihet re ndarja e dy njësive, që përkon edhe me ndarjen e pallatit. Subjekti ka konfirmuar se kjo mosmarrëveshje sipas informacionit të marrë prej tij nga këto njësi është e hershme dhe, për shkak të problematikave që ka, vendndodhja e pallatit në të cilin ai banon (kryqëzimi i rrugës “\*\*\*” dhe “\*\*\*”). Subjekti thekson se kjo gjë vërtetohet lehtësisht edhe nga leja e ndërtimit e dalë për këtë ndërtesë. Subjekti ka sqaruar se deklarimi i kësaj adrese (Njësia Administrative Nr. \*\*\*) është bërë bazuar edhe në adresarin e dërguar nga Ministria e Brendshme dhe Bashkia Tiranë pranë shtëpive të çdo qytetari të Tiranë, të cilin gjithashtu e ka vendosur në dispozicion. Lidhur me kërkesën e subjektit nr. \*\*\* prot., datë 9.10.2017 (objekt i verifikimit dhe sqarimit të këtij hetimi) drejtuar Drejtorisë së ALUIZNI-t Tirana \*\*\*, subjekti ka deklaruar se ajo është vetëm një kërkesë rutinë (shkruar me shkrim dore dhe në kushte të papërshtatshme) pas disa dhjetëra kërkesave të bëra në atë institucion për hipotekimin e objektit që ai banon, si shumë nga banorët e pallatit ku jeton. Ai ka qartësuar se edhe atë ditë që është bërë ajo kërkesë (“*Pasi kemi qenë disa banorë të pallatit*”), kanë pasur këtë problematikë; disa nga banorët kanë deklaruar Njësia Administrative Nr. \*\*\* dhe disa të tjerë, ku është përfshirë vetë ai, kanë deklaruar Njësia Bashkiake Nr. \*\*\*. Subjekti ka shpjeguar se kjo mospërputhje adresash është një problematikë për këtë pallat edhe sot e kësaj dite.

**b.** Në vijim të konstatimit të disa mospërputhjeve rezultoi se në kartelën e pasurisë së paluajtshme të llojit apartament, numri i pasurisë identifikohet si \*\*\*, sipas genplanit të përcjellë nga ASHK-ja, pasuria identifikohet me nr. \*\*\* sipas të dhënave të pagesës për efekt të taksës së ndikimit në infrastrukturë në emër të subjektit dhe bashkëshortes së tij, pasuria konfirmohet me nr. \*\*\*, në ndryshim nga informacioni i ASHK-së, ku konfirmohet pasuria me nr. \*\*\*.

i. Lidhur me mospërputhjet e numrave të pasurisë, subjekti<sup>9</sup> konfirmoi se kishte paraqitur kërkesë pranë ASHK Drejtoria Vendore Tirana \*\*\*, zonë e cila mbulonte pasurinë e tij, dhe se në përgjigjen e tyre shteruese është cituar: “*Pavarësisht faktit që në këtë leje legalizimi është cituar numri i pasurisë nr. \*\*\*, rezulton se kjo pasuri i përket nr. \*\*\*, e regjistruar në volumnin \*\*\*, faqe \*\*\*, apartament me sipërfaqe 87.2 m<sup>2</sup>, në bashkëpronësi me 1/2 pjesë takuese në emër të Spartak Mitrushit dhe K.M. ASHK-ja në informacionin e saj ka sqaruar se në shumicën e rasteve numrat e pasurive të vendosura në lejen e legalizimit janë numra provizorë dhe në momentin e regjistrimit bëhet përrputhja me hartën e zyrës së ASHK-së, ku vendoset numri përfundimtar i objektit, ku në rastin konkret është nr. \*\*\**”. Subjekti është shprehur edhe mbi gabimet e shumta të pasqyruara në lejen e legalizimit, duke theksuar se nuk e di arsyen e këtyre gabimeve, porse në momentin që i ka konstatuar, ka kërkuar nga autoritetet përgjegjëse korrigjimin e tyre. Ai ka sqaruar se disa nga

<sup>7</sup> Me pyetësin nr. 3, datë 9.10.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>8</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.10.2024, e Njesisë Administrative Nr.\*\*\* dhe shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2024, e Njesisë Administrative Nr. \*\*\*.

<sup>9</sup> Me pyetësin nr. 3, datë 9.10.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

këto gabime janë korigjuar e disa të tjera jo. Subjekti ka sjellë në vëmendje edhe periudhën e ngarkuar për shkak të pandemisë Covid-19, ku për shkak të prekjës prej saj nuk ka pasur kohë të vazhdojë me rregullimin e gabimeve. Ndërkohë ka konfirmuar se duke marrë shkas nga ky proces, i është drejtuar përsëri ASHK-së, Drejtorisë Vendore Tirana \*\*\*, për saktësimin e të gjitha mospërputhjeve dhe hedhjen e saktë jo vetëm të sipërfaqes së apartamentit, por edhe të ballkoneve, pasi ato sipas subjektit nuk figurojnë në kartelën e pasurisë. Më ekzaktësisht, subjekti ka sqaruar se në gabimet e konstatuara një nga gabimet e tij leje ka qenë, përveç adresës së pasaktë, edhe vendosja si kondicioni i veçantë i verandës 10.9 m<sup>2</sup>. Subjekti ka sqaruar: *“Së pari, unë banoj në katin e \*\*\* të pallatit ose në katin e \*\*\* të banueshëm, duke pasur edhe \*\*\* kate të tjera më sipër, dhe nuk kam si të kem verandë. Gabimi qëndron se si referencë për legalizimin e apartamentit tim është marrë legalizimi i një apartamenti, i cili ndodhet një kat më sipër apartamentit tim. Nuk di të them se për cilën arsye është marrë kjo referencë. ...në apartamentit tim unë posedoj vetëm dy ballkone dhe jo një verandë, vërtetuar kjo edhe sipas genplanit... bashkëngjitur lejes së legalizimit (për të cilin kam bërë vërejtjet përkatëse, pasi edhe ai ka shumë gabime”*.

ii. Subjekti ka bashkëlidhur fotot e dy ballkoneve, për të cilat shpjegon se njëri prej tyre, për shkak të përmasave që ka, është pothuajse i papërdorshëm, por (ka sqaruar ai) ndërtuesit që operojnë në Tiranë faturojnë tek blerësit edhe metra katrorë ndërtim të pashfrytëzueshëm. Një gabim tjetër i konfirmuar nga subjekti i përket numrit të kateve në lejen e legalizimit. Ai ka sqaruar se objekti është shënuar “shtesë kati 1 kat në objekt ekzistues shtatë kate + dy kate nëntokë”, duke vijuar më tej: *“Së pari, ky shënim është tërësisht i gabuar, pasi leja e ndërtimit të këtij objekti (të cilën po jua vë në dispozicion) është 8 kate dhe apartamenti im, në të cilin banoj, është në katin e \*\*\* të banimit, duke pasur dhe \*\*\* kate më sipër që janë ndërtuar jashtë lejes. Së dyti, aq të dukshme janë këto gabime jo vetëm për mua që jetoj përditë në këtë apartament (e kam fjalën për planimetrinë e brendshme të tij), por edhe po ta shohësh me sy të lirë në krye të këtij dokumenti thuhet me shkronja kapitale PLANIMETRIA E KATIT TË SHTATË dhe në fund të tij tek rubrika “Emërtimi i fletës” është thënë PLANIMETRIA E KATIT TË TETË”. Subjekti ka kërkuar që për transparencë pasuria të verifikohet edhe në vend nga një person apo grup personash. “Së treti, në të dyja katet që ndodhen sipër apartamentit tim, banon familja e ndërtuesit të këtij pallati, pronari i firmës ndërtuese “I” sh.p.k., e cila ka dalë nga leja e ndërtimit, duke ndërtuar dy kate pa leje, kati në të cilin jetojnë vetë. Ndërtimi i kateve pa leje ka sjellë mosregjistrimin e këtij pallati në ASHK prej më shumë se 17 vjetësh nga përfundimi i ndërtimit, duke na detyruar ne si banorë t’i drejtohem procesit të legalizimit individualisht”. Subjekti, për të provuar këtë fakt, ka depozituar një vendim gjyqësor, për të cilin sqaron se njëri nga pronarët e tokës (familja L) ka paditur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë shoqërinë ndërtuese “I” sh.p.k., ndër të tjera edhe për ndërtimin e këtyre dy kateve pa leje (Për më tepër, sqaron subjekti, në faqen 12 të vendimit është dhe konstatimi i gjykatës për katet pa leje).*

iii. Komisioni, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të administruar, vërejtë se ai ka konfirmuar se ka porositur një apartament sipas kontratës së sipërmarrjes që ka depozituar më parë prej 107 m<sup>2</sup> (bashkë me ambientet e përbashkëta) dhe, nëse do të kishte ndërtuar një kat shtesë pa leje, atëherë apartamenti i tij (gjithnjë sipas shpjegimit të subjektit) do të ishte mbi 200

m<sup>2</sup>, gjë e cila sipas tij nuk është e vërtetë, pasi certifikata e tij e pronësisë së këtij apartamenti citon 87 m<sup>2</sup> (pa ambientet e përbashkëta).

iv. Sipas të dhënave të adresuara nga subjekti, rezulton se pasuria ndodhet në godinën 8 kate, referuar lejes së ndërtimit 5, 7 dhe 8 kate, përkundër faktit që leja e legalizimit ka dalë për pasuri të ndodhur në godinën 7 kat + 2 kate nëntokë. Konfirmimin e vendndodhjes së pasurisë së tij subjekti e lidh edhe me arsyetimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në vendimin e saj nr. \*\*\*, datë 24.7.2023, ku në faqen 12 arsyetohet mbi shtesën e bërë prej dy katesh ndërtimi pa leje në godinën 10 kate mbi tokë. Pra, thuhet se ka dy kate shtesë mbi tokë (pasi leja e ndërtimit ka qenë miratuar për 8 kate mbi tokë).

v. Nga dokumentacioni i depozituar prej subjektit, të dhënat e përcjella nga ASHK-ja konfirmojnë se pasuria është me nr. \*\*\*, pasi numri i pasqyruar në lejen e legalizimit ka qenë provizor. Gjithashtu, ASHK-ja<sup>10</sup> ka konfirmuar se në emër të z. Spartak Mitrushit rezulton vetëm pasuria nr. \*\*\* e llojit apartament, me sipërfaqe 87.2 m<sup>2</sup>, ndërsa pasuria nr. \*\*\* nuk rezulton në sistemin e pasurive të paluajtshme. ASHK-ja sqaron edhe faktin se pasuria nr. \*\*\*, e pasqyruar në genplanin e përcjellë prej vetë këtij institucioni, në raport me numrin e pasurisë së identifikuar në informacionin e dhënë në shkresë, si pasuria me nr. \*\*\*, nuk është i njëjtë me numrin e pasurive në hartën kadastrale të pasurive të paluajtshme, duke konfirmuar në këtë mënyrë se nuk kemi të bëjmë me dy pasuri të ndryshme.

c. Mospërputhje u vërejt edhe në numërtimin e lejes së legalizimit, e cila mban numrin \*\*\*, datë 18.6.2020, ndërsa në përshkrimin e pasqyruar në kartelën e pasurisë veranda duket të jetë legalizuar me lejen nr. \*\*\*, datë 18.6.2020. Lidhur me këtë mospërputhje, subjekti<sup>11</sup> ka konfirmuar se nuk posedon asnjë metër katror verandë: Ai ka deklaruar se: *“Bëhet fjalë vetëm për dy ballkone, nga të cilat njëri është pothuajse i papërdorshëm për shkak të përmasave që ka. Ngatërresa e numrit 3 me numrin 2 mund të jetë një gabim material, siç na ndodh rëndom nëpër shkresat tona. Në kohën e daljes së këtij dokumenti vendi ynë ka qenë në kohën e Covid-19, çka mund të ketë pasuar edhe në gabime materiale nga ana e punonjësve. Nuk besoj se kjo ngatërresë është një problematikë në procesin tim të Vetting-ut”*.

Në lidhje me këtë mospërputhje, ASHK-ja<sup>12</sup> konfirmon se pas verifikimeve të bëra lidhur me lejen e emetuar në emër të subjektit ajo mban numrin \*\*\*, datë 18.6.2020 dhe se nr. \*\*\* është thjesht një gabim në hedhjen e materialit kur është bërë pasqyrimi i saj në kartelë.

**18.5** UKT sh.a.<sup>13</sup> informon se në emër të shtetasit Spartak Mitrushit rezulton e regjistruar kontrata nr. \*\*\* për objektin me adresë rruga “\*\*\*\*”, Tiranë, kategoria familjare, statusi aktiv. Referuar kontratës së sipërmarrjes, kjo adresë i përket adresës së dhënë nga subjekti për këtë apartament, në kontratën e sipërmarrjes, në vitin 2006.

<sup>10</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.10.2024, depozituar nga subjekti, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>11</sup> Me pyetësorin nr. 3, datë 9.10.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>12</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.10.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>13</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.8.2021, administruar në dosjen e Komisionit.



**18.6** FSHU-ja<sup>14</sup> informon se me gjeneralitetet Spartak Mitrushi rezultojnë dy abonentë me kontratë furnizimi nr. \*\*\* në instancën Tiranë dhe nr. \*\*\* në instancën Vlorë. Kontrata e furnizimit në instancën Tiranë rezulton të jetë lidhur në datën 11.10.2007, me vendndodhje në adresën e apartamentit objekt hetimi, rruga “\*\*\*\*”, \*\*\*, kategoria familjare, statusi aktiv. Për sa i përket kontratës së furnizimit në instancën Vlorë në emër të shtetasit Spartak Mitrushi, Komisioni bazuar në të dhënat e marra në regjistrin e gjendjes civile konstatoi se ka dy shtetas me të njëjtat gjeneralitete: shtetasi Spartak G Mitrushi i datëlindjes \*\*\*.\*\*\*.1969, banues në Tiranë, si dhe shtetasi S. Dh. M, i datëlindjes \*\*\*.\*\*\*.1957, banues në lagjen “\*\*\*\*”, Vlorë.

**18.7** Nga analizimi i dokumentacionit të administruar, por edhe në raport me shpjegimet e subjektit, Komisioni konstatoi se: (i) ASHK-ja e ka konfirmuar këtë pasuri të regjistruar në emër të tij; (ii) ASHK-ja nuk ka konfirmuar pasuri tjetër në emër të subjektit; (iii) nga të dhënat në regjistrin noterial nuk rezulton ndonjë kontratë tjetër noteriale për pasuri tjetër të porositur apo blerë prej tij; (iv) sipas lejes së ndërtimit provohet miratimi i ndërtimit të tri godinave, ku përfshihet edhe godina 8 kate, ku subjekti deklaron se përfshihet apartamenti i tij; (v) FSHU-ja dhe UKT-ja kanë konfirmuar kontratë furnizimi vetëm për një pasuri.

**18.8** Në këto kushte, në tërësi lidhur me mospërputhjet e konstatuara për këtë pasuri, pas informacioneve të marra, deklarimeve të subjektit dhe vlerësimit të provave në harmoni me njëra-tjetrën, duket se nuk evidentohet ndonjë problematikë lidhur me këtë pasuri për efekt të këtij procesi.

### **Lidhur me burimin e krijimit dhe pagesat e kryera për këtë pasuri**

**18.9** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se si burim krijimi për këtë pasuri ka shërbyer: (i) kredia e marrë në Societe Generale Bank (ish-Banka Popullore) në shumën 35.000 euro; (ii) të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz” në shumën 1.500.000 lekë; (iii) kursime të familjes. Komisioni hetoi për secilin nga burimet e deklaruara dhe i rezultoi si më poshtë detajuar.

#### **18.9.1 Lidhur me kredinë e marrë në Societe Generale Bank, në shumën 35.000 euro**

**18.9.1.a** Nga korrespondenca e Komisionit me OTP Bank, kjo e fundit informon<sup>15</sup> se shtetasja K.F.M ka marrë kredi në monedhën euro, hapur në datën 8.2.2007, në shumën 35.000 euro, e cila rezulton e mbyllur më 30.1.2015. Banka ka vendosur në dispozicion të Komisionit edhe kontratën për hua afatgjatë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 6.10.2006, me palë huamarrëse shtetasit K.P (mbiemri i vajzërisë) dhe Spartak Mitrushi, në shumën 35.000 euro, me qëllim blerje apartament banimi. Kolateral për këtë kredi rezulton se është vendosur pasuria e paluajtshme në emër të subjektit Spartak Mitrushi, me nr. \*\*\*, e ndodhur në zonën kadastrale \*\*\*, pasuri e përbërë nga apartament me sipërfaqe<sup>16</sup> 54.5 m<sup>2</sup>, e regjistruar në regjistrat e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme të rrethit Fier. Nga analizimi i llogarisë së kredisë rezulton se kredia në fjalë është

<sup>14</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.7.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>15</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.8.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>16</sup> Kjo pasuri është trajtuar në këtë vendimmarrje.

disbursuar me dy këste, konkretisht 22.000 euro në datën 8.2.2007 dhe 13.000 euro në datën 7.6.2007.

**18.9.1.b** Për sa rezultoi më sipër, por edhe për sa kohë kjo kredi është akorduar nga një institucion financiar, trupi gjykues duket se nuk konstatoi ndonjë problematikë lidhur me ligjshmërinë e këtij burimi.

### **18.9.2 Lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz” në shumën 1.500.000 lekë**

**18.9.2.a** Sa i përket këtyre të ardhurave, subjekti i rivlerësimit ka depozituar me deklaratën *Vetting* kontratën e shitblerjes<sup>17</sup> së automjetit, në të cilën rezulton se ai i ka shitur në datën 26.3.2008 shoqërisë “H” sh.p.k. automjetin e tij tip “Mercedes-Benz”, me targë \*\*\*, në vlerën 1.500.000 lekë. Në kontratë cilësohet se vlera 1.500.000 lekë është likuiduar e plotë nga pala blerëse për palën shitëse.

Për të vlerësuar ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, Komisioni i ka kërkuar<sup>18</sup> subjektit të depozitojë kontratën e blerjes së këtij automjeti. Subjekti ka sqaruar: *“Kontrata e blerjes së këtij automjeti është nënshkruar në datën 1.8.2007, me shitës D.P (djali i xhaxhait të bashkëshortes K), me vlerë blerjeje 250.000 lekë. Vlera e shitjes ishte simbolike për shkak të marrëdhënies së ngushtë dhe familjare me shitësin, i cili vlerën reale të tregut na e konsideroi dhuratë. Kjo vlerë blerjeje është likuiduar me kursimet tona. Automjeti është blerë sipas aktit kontratë shitblerjeje automjeti me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., të mbajtur në Tiranë në datën 1.8.2007, në zyrën e noterit R.T. Vlera e mjetit ka qenë simbolike, për faktin se ka qenë më tepër dhurim mjeti për shkak të lidhjes miqësore (gjaku) me shitësin, siç jua kam sqaruar më sipër”*.

**18.9.2.b** DPSHTRR-ja<sup>19</sup> ka përcjellë dosjen e plotë të këtij automjeti. Nga verifikimi i dosjes rezulton se subjekti i rivlerësimit e ka blerë automjetin në datën 1.8.2007 nga shtetasi D.P në vlerën 250.000 lekë dhe e ka shitur më 26.3.2008 në vlerën 1.500.000 lekë tek shoqëria “H” sh.p.k.

**18.9.2.c** Automjeti rezulton se është zhdoganuar në datën 24.2.2007 për bazën e taksueshme 988.017 lekë dhe TVSH-në 469.765 lekë. Në total, vlera e automjetit rezulton 1.457.785 lekë. Nga ana tjetër, rezultoi se edhe shoqëria “H” sh.p.k. e ka shitur më vonë këtë automjet në vlerën 1.200.000 lekë, çka duket se krijon bindjen që vlera e këtij automjeti në momentin që e ka shitur subjekti mund të ketë qenë 1.500.000 lekë.

**18.9.2.ç** Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se nuk konstatohen problematika lidhur me ligjshmërinë e këtyre të ardhurave.

### **18.9.3 Lidhur me kursimet familjare**

**18.9.3.a** Lidhur me marrëdhënien e punësimit të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në deklaratën *Vetting*, por edhe gjatë hetimit dokumentacion përkatës.

<sup>17</sup> Nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 26.3.2008. Aneks nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>18</sup> Me pyetësin nr. 2, datë 6.9.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>19</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

**18.9.3.b** Në pyetësin nr. 2, subjekti ka deklaruar se nga viti 1998 deri në vitin 2006 ka qenë i punësuar pranë shoqërisë “N. V”, i padeklaruar, me pagë neto 50.000 lekë/muaj. Ndërsa për periudhën mars 2006 – gusht 2009 ka deklaruar se ka qenë i punësuar tek shoqëria “A. C” sh.p.k., ku ka qenë i deklaruar me pagë minimale, por paga reale ka qenë 100.000 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se:

i. Periudha e punësimit pranë shoqërisë “N. V.” për vitet 1998 – 2006 nuk u provua me dokumentacion. Shuma e deklaruar prej 50.000 lekësh në muaj, që është përfituar nga kjo shoqëri, duket se ka mbetur vetëm në nivel deklarativ.

ii. Për periudhën mars 2006 – gusht 2009, subjekti i rivlerësimit ka qenë i punësuar pranë shoqërisë “A. C” sh.p.k. dhe, sipas vërtetimit datë 24.1.2017, lëshuar nga kjo shoqëri, subjekti ka përfituar 614.146 lekë për këtë periudhë.

iii. Për periudhën gusht 2009 – dhjetor 2013, subjekti i rivlerësimit ka qenë i punësuar pranë Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës F, me detyrë drejtor, dhe sipas vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 20.10.2006, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, ka përfituar 2.702.736 lekë për këtë periudhë.

iv. Për periudhën 10.6.2015 – 31.12.2016, subjekti i rivlerësimit ka qenë i punësuar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, me detyrën ndihmës ligjor dhe sipas vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 12.1.2017, nga Gjykata Administrative e Apelit. Subjekti ka përfituar 1.474.029 lekë për këtë periudhë.

v. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e subjektit, rezulton se ajo ka qenë e punësuar në sistemin bankar. Për periudhën prill 2005 – korrik 2014, ajo ka qenë e punësuar pranë bankës Societe Generale Albania, sot OTP, dhe ka përfituar 11.498.449 lekë për këtë periudhë. Më tej, prej gushtit 2014 deri në dhjetor 2016, ajo figuron pranë Intesa Sanpaolo Bank, ku ka përfituar 4.109.377 lekë për këtë periudhë.

**18.9.3.c** Për sa më sipër, Komisioni nuk i ka marrë në konsideratë të ardhurat e përfituara gjatë periudhës së punësimit, ku subjekti ka qenë i padeklaruar nga punëdhënësi, konkretisht pranë shoqërisë “N. V”, për sa kohë ato nuk janë përfituar sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

## **18.10 Lidhur me mënyrën e likuidimit të kësaj pasurie**

**18.10.1** Subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar me shoqërinë e ndërtimit “I” sh.p.k. kontratën e sipërmarrjes<sup>20</sup> datë 12.9.2006 për blerjen e apartamentit të banimit me sipërfaqe 107 m<sup>2</sup> (ku 93 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi dhe 14 m<sup>2</sup> sipërfaqe të përbashkët), në kryqëzimin e rrugëve “\*\*\*\*” dhe “\*\*\*\*”, Tiranë. Në nenin 3 të kontratës cilësohet se: *Vlera totale e apartamentit është 75.000 euro dhe pagesa do të kryhet me këste. Kësti i parë prej 40.000 euro është likuiduar ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate nga porositësi tek sipërmarrësi dhe ky i fundit deklaroi se e mori shumën dhe nuk ka asnjë pretendim për këtë shumë të marrë jashtë zyrës. Diferenca tjetër do të likuidohet deri ditën e marrjes së çelësave në dorë.*

<sup>20</sup> Aneks nr. 4/2, në dosjen e ILDKPKI-së.

**18.10.2** Komisioni mbajti korrespondencë me shoqërinë e ndërtimit “I” sh.p.k., ku i kërkoi informacion dhe dokumentacion për kohën dhe mënyrën e likuidimit të këtij apartamenti nga ana e subjektit të rivlerësimit. Në përgjigje<sup>21</sup>, shoqëria ndërtuese “I” sh.p.k. ka informuar: *“Klienti ynë Spartak Mitrushi dhe K.M ka porositur një apartament sipas kontratës së sipërmarrjes. Pagesa është bërë në arkën e shoqërisë, duke filluar në vitin 2005 dhe ka përfunduar në vitin 2010. Klienti nuk ka pasur dhe nuk ka asnjë mosmarrëveshje me shoqërinë tonë deri më sot”*. Për sa i përket faturave, shoqëria ka bërë me dije se nuk i ka ato të ruajtura, pasi ligji për ruajtjen e dokumentacionit ka një afat prej 5 vjetësh dhe se shoqëria ka ndryshuar disa herë zyrat dhe, duke pasur një volum shumë të madh pune dhe dokumentesh, nuk ka pasur mundësi teknike për ruajtjen e tyre.

**18.10.3** Komisioni i kërkoi<sup>22</sup> gjithashtu shpjegime edhe subjektit të rivlerësimit, që të qartësonte mënyrën e likuidimit të këtij apartamenti, si dhe burimin e krijimit të shumës 40.000 euro si këst i parë.

**18.10.4** Subjekti në përgjigje ka sqaruar se: *“Si fillim duhet saktësuar se në kontratën e sipërmarrjes është deklaruar që kësti i parë prej 40.000 euro është paguar me nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes. Kjo kontratë ishte një kontratë tip, që ndërtuesi dhe të gjithë ndërtuesit përdorin rëndom, por të dyja palët arritëm në marrëveshje që kjo shumë të likuidohej gradualisht nga ana jonë, deri në marrjen e certifikatës hipotekore. Kjo gjë mund të verifikohet nga kompania, duke qenë se të gjitha pagesat janë bërë cash në zyrat e kompanisë”*. Subjekti ka konkretizuar mënyrën e pagesës së vlerës totale të apartamentit 75.000 euro, paraqitur në tabelën vijuese.

Viti	Shuma	Përshkrimi
<b>Nëntor 2005</b> <sup>23</sup>	EUR 10,000	Nga revokimi i kontratës së prenotimit të apartamentit të parë, financuar me kredinë 20.000 euro
<b>Shtator 2006</b> <sup>24</sup>	EUR 10,000	Kursime nga paga e bashkëshortes K (5.000 euro) dhe subjektit së bashku (5.000 euro)
<b>Viti 2007</b>	EUR 10,000	Kursime nga paga e bashkëshortes K dhe subjektit së bashku
	EUR 15,000	Nga kredia disbursuar në datën 8.2.2007
	EUR 13,000	Nga kredia disbursuar në datën 8.6.2007
<b>Viti 2008</b>	EUR 10,000	Nga shitja e automjetit sipas kontratës datë 26.3.2008
<b>Viti 2009</b>	EUR 5,000	Kursime nga paga e bashkëshortes K dhe subjektit së bashku
<b>Viti 2010</b>	EUR 2,000	Kursime nga paga e bashkëshortes K dhe subjektit së bashku
<b>Totali</b>	<b>EUR 75,000</b>	

**18.10.5** Subjekti ka vijuar të sqarojë se: *“...Përveç burimit të financimit me anë të kredisë bankare, burim tjetër të ardhurash kanë qenë kursimet e mia, të bashkëshortes dhe familjarëve. Mënyra e likuidimit ka qenë e gjitha në arkën e shoqërisë. Koha e likuidimit të çmimit të këtij apartamenti*

<sup>21</sup> Me shkresën datë 17.4.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>22</sup> Me pyetësin nr. 2, datë 6.9.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>23</sup> Mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 7.11.2005, për shumën 10.000 euro. Përshkrimi “Likuiduar këst për apartamentin e blerë në objektin polifunksional 5-7 dhe 8 kate në rrugën “\*\*\*”, Tiranë”.

<sup>24</sup> Mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 15.9.2006, për shumën 10.000 euro. Përshkrimi “Likuidim kësti për apartamentin e blerë në objektin polifunksional, në rrugën “\*\*\*”, Tiranë”.

*ka qenë pak e gjatë dhe ka përfunduar në vitin 2010, për shkak edhe të problematikave që ka dhe sot e kësaj dite ky apartament ose më saktë ky pallat (mosbërja e hipotekave nga ana e ndërtuesit). Në këto kushte, pas shumë kërkesave të bëra nga ana ime, kam arritur ta legalizoj dhe ta hipotekoj këtë apartament në mënyrë individuale, siç kanë bërë dhe disa nga komshinjtë e mi”.*

**18.10.6** Lidhur me pagesën e muajit nëntor 2005 në shumën 10.000 euro me burim nga revokimi i kontratës së apartamentit të parë, financuar me kredinë 20.000 euro, subjekti ka sqaruar<sup>25</sup>: *“Jam financuar në datën 5.7.2005 nga ish-Banka Popullore me një kredi 20.000 euro, me afat 7 vjet, me qëllim blerje apartamenti. Në këtë periudhë kishim prenotuar një apartament te kompania “K” sh.p.k. në rrugën “\*\*\*”. Kopje të kontratës së prenotimit nuk kemi ruajtur<sup>26</sup>, kontaktuam dhe kompaninë aktualisht dhe nuk i kanë ruajtur kontratat e porosisë të vitit 2005. Kjo kredi është disbursuar në llogari në datën 12.7.2005 dhe po në këtë datë është bërë tërheqje cash e gjithë shuma, e cila është paguar cash te kompania “K”. Disa muaj më vonë, këtë kontratë e revokuam, pasi gjetëm një apartament me vendndodhje dhe me çmim më të mirë (apartamenti që jetojmë aktualisht) dhe rimorëm mbrapsht vlerën e paguar 20.000 euro, por me disa pjesë nga pala e tretë (prenotuesi i apartamentit që ne revokuam). Nga kjo vlerë kemi arkëtuar 9.500 euro në datën 7.11.2005 dhe po në këtë datë kemi arkëtuar vlerën 10.000 euro tek zyrat e kompanisë (sipas mandatar-këtimit bashkëngjitur). Kredia 20.000 euro është mbyllur gradualisht një pjesë në 2005, një pjesë në 2006 dhe përfundimisht është mbyllur në shkurt 2007 me disbursimin pjesor të kredisë 35.000 euro”.*

**18.10.7** Komisionit, nga analizimi i dokumentacionit të depozituar nga OTP Bank (ish-Societe Generale Bank, ish-Banka Popullore), i rezultoi se në datën 5.7.2005 shtetasit K.P dhe Spartak Mitrushi kanë nënshkruar kontratën për hua afatgjatë nr. \*\*\* rep. nr. \*\*\* kol., në vlerën 20.000 euro, me qëllim blerje apartamenti. Rezultoi se kredia e huas është siguruar në bankë nga kredimarrësit me kontratën e hipotekës<sup>27</sup> të pasurisë së paluajtshme në pronësi të subjektit të rivlerësimit, pasuria e llojit apartament me sipërfaqe 54,5 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, e ndodhur në zonën kadastrale nr. \*\*\*, Fier. Kjo kredi është disbursuar në datën 12.7.2005 dhe po në këtë datë është tërhequr shuma 20.000 euro. Rezultoi se kjo kredi është mbyllur në vitin 2007. Përveç pagesave/kësteve mujore, rezulton se në datën 30.11.2005 është shlyer shuma 7.270,9 euro dhe në datën 8.2.2007 është paguar shuma 7.167,35 euro, ku me këtë shumë kredia është mbyllur totalisht. Sa i përket shlyerjes së datës 8.2.2007 në vlerën 7.167,35 euro ajo ka pasur burim krijimi kredinë e disbursuar në datën 8.2.2007. Për këtë kredi subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë nënshkruar kontratën për hua afatgjatë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 6.10.2006, me ish-Bankën Popullore (sot OTP) për vlerën 35.000 euro me qëllim blerje apartament banimi. Për këtë kredi është lënë kolateral pasuria e paluajtshme apartament banimi me sipërfaqe 54,4 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, z. k.\*\*\*, Fier, në emër të z. Spartak Mitrushi. Konkretisht, veprimet që janë kryer me këtë kredi rezultojnë si më poshtë:

<sup>25</sup> Me pyetësoin nr. 2, datë 6.9.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>26</sup> Subjekti ka depozituar së bashku me prapësimet kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 26.5.2004, si dhe kontratën nr. \*\*\*, datë 20.10.2005, për revokimin e kontratës së sipërmarrjes.

<sup>27</sup> Kontrata e hipotekës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.7.2005, administruar me përgjigjen e OTP Bank, shkresë nr. \*\*\* prot., datë 3.8.2021.

i. Në datën 8.2.2007 është disbursuar vlera 22.000 euro (kësti i parë i shumës 35.000 euro) dhe po në këtë datë është transferuar brenda llogarive shuma 7.167,35 euro për të mbyllur kredinë e marrë në vitin 2005, në vlerën 20.000 euro.

ii. Në datën 8.2.2007 është tërhequr shuma 15.000 euro, ku duket se korrespondon me deklarinimin e subjektit për likuidimet e kryera gjatë vitit 2007 për blerjen e apartamentit.

iii. Në datën 7.6.2007 është disbursuar vlera 13.000 euro (kësti i dytë i shumës 35.000 euro) dhe janë tërhequr në datën 7.6.2007 shuma 5.000 euro dhe në datën 8.6.2007 shuma 8.000 euro. Shuma e dy tërheqjeve korrespondon me deklarinimin e subjektit për likuidimet e kryera gjatë vitit 2007 për blerjen e apartamentit.

**18.10.8** Këto transaksione, lidhur me shumatat e paguara për likuidimin e apartamentit dhe kohën e shlyerjes, përputhen me deklarinimin e subjektit.

**18.10.9** Komisioni, nisur nga fakti se: (i) subjekti nuk ka qenë subjekt deklarues; (ii) nuk ka bërë deklarime periodike; (iii) nuk ka dokumentacion mbështetës për datën e saktë të secilës pagesë – ka vlerësuar të kryejë analizën financiare për likuidimin e kësaj pasurie për periudhën 2005 – 2010. Për këtë periudhë janë përfshirë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e identifikuara.

**18.10.10** Për sa është analizuar më sipër për këtë pasuri, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit: (i) nuk ka pasur mundësi financiare në vlerën 2.581.768 lekë të investojë në pasurinë apartament banimi, si dhe të përballojë të gjitha shpenzimet e tjera familjare; (ii) nuk provohen me dokumentacion të ardhurat reale të përfituara nga punësimi i subjektit të rivlerësimit për periudhën nga viti 1998 – 2006 pranë shoqërisë “N.V”, dhe për periudhën mars 2006 – gusht 2009 pranë shoqërisë “A.C” sh.p.k. Në këto kushte<sup>28</sup>, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e këtij konstatimi.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**18.10.11** Subjekti në parashtrimet e tij fillimisht ka vendosur fokusin në punësimin që në moshë të vogël (18 vjeç), duke depozituar edhe vërtetimin përkatës nga arkivi i ISSH-së, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore F, me nr. \*\*\* prot., datë 24.5.2021, për të cilin qartëson se në të është përshkruar periudha e punës pranë N së R-F të I. të Sh. F (NRFISH F) nga data 2.12.1987 deri më 4.3.1988, si dhe dokumentin nr. \*\*\* prot., datë 24.5.2021, të nxjerrë nga arkivi i ISSH-së, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore F, ku përshkruhet se ka filluar punë pranë N Shpim-Sh. N. P., në datën 17.3.1988 dhe ka punuar deri në datën 7.1.1989. Subjekti ka deklaruar se ka qenë në marrëdhënie pune gjatë gjithë jetës (nga viti 1987 dhe deri më sot) dhe se, përveç periudhës kohore nëntor 2013 – maj 2015, nuk ka qenë asnjëherë i papunësuar.

**18.10.12** Subjekti është shprehur edhe mbi rrethanat familjare të viteve të hershme, të cilat sipas tij kanë qenë të tilla duke mos i dhënë mundësinë e vëmendjes së duhur për dokumentimin e periudhës së punës.

**18.10.13** Subjekti ka shpjeguar se fakti që nuk i ka të dokumentuara këto vite pune, nuk mund të përbëjë shkak për penalizimin e tij, për sa kohë ka arritur të sigurojë prova të tërthorta me anë të

<sup>28</sup> Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

të cilave ai kërkon të provojë dhe të krijojë bindjen para Komisionit se ka realizuar të ardhura për gjithë këtë periudhë, të cilat sipas subjektit duhet të konsiderohen në analizën financiare. Subjekti ka theksuar se gjatë kësaj periudhe: (i) ka përfunduar studimet (të cilat kanë shpenzimet e tyre); (ii) është fejuar dhe martuar (të cilat kanë dhe këto shpenzimet e tyre); (iii) ka bërë udhëtime jashtë vendit për arsye pune dhe pushimesh; (iv) ka marrë pjesë në shumë ngjarje të miqve, shokëve dhe familjes së tij dhe se, në rast se do të kishte qenë i papunë dhe pa të ardhura, nuk do të kishte asnjë mundësi t'i realizonte këto të ardhura.

**18.10.14** Subjekti ka parashtruar se për pamundësinë e krijimit të shumës prej 2.581.768 lekësh, për të cilën Komisioni i ka ngarkuar barrë prove, nëse ndahet ndër vite (për 5 vite), rezulton një shumë prej 35.000 lekësh në muaj. Në këtë këndvështrim, ka sqaruar subjekti, duke marrë parasysh edhe pagat e asaj kohe, nuk mund të lindin dyshime që nuk është paguar të paktën me një pagë në masën 50.000 lekë, ku sikurse deklaron, ka mbajtur pozicionin më të lartë pas administratorit.

**18.10.15** Subjekti ka deklaruar se pagesa që shoqëria “A.C” sh.p.k. ka bërë për të në organet tatimore, ka qenë në masën 12.300 lekë, gjë e cila sipas tij nuk mund të ketë qenë e vërtetë, pasi deklaron se nuk ka pasur asnjë të punësuar në atë kohë me atë pagë (në shoqërinë “A.C” sh.p.k.), të cilën po ta krahasosh edhe me minimumin jetik të përcaktuar nga qeveria pothuajse është e barabartë.

**18.10.16** Subjekti ka deklaruar se në atë kohë ky fenomen, sidomos nga shoqëritë me pronar shtetas grekë, ka qenë mjaft i përhapur. Subjekti deklaron se këto argumente i konkretizon duke marrë shkas edhe nga thirrjet e fundit të bëra nga qeveria për mosdeklarimin e saktë të pagave, duke rikujtuar në këtë rast edhe një herë kohën dhe periudhën për të cilën po flasim.

**18.10.17** Në lidhje me mosprovueshmërinë e dokumentacionit për të ardhurat reale të përfituara nga punësimi i tij për periudhën 1998 – 2006 pranë shoqërisë “N.V” sh.p.k. dhe për periudhën mars 2006 – gusht 2009 pranë shoqërisë “A.C” sh.p.k., të cilat nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni, pasi ka qenë i padeklaruar nga punëdhënësi, për sa kohë ato nuk janë përfituar në zbatim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjekti ka deklaruar se punësimi i tij pranë shoqërisë “N.V” sh.p.k. dhe shoqërisë “A.C” sh.p.k. ka qenë i dukshëm, që, përveçse vërtetohet me vërtetimin e lëshuar nga Agjencia Doganore D, vërtetohet edhe nga hyrje-daljet në sistemin TIMS. Ai ka konfirmuar se pjesa më e madhe e të gjitha udhëtimit të tij jashtë vendit kanë qenë në funksion të punës që bënte pranë këtyre dy shoqërive. Ai ka konfirmuar se në të gjitha zhdoganimet dhe hyrje-daljet e mallrave të këtyre shoqërive ka qenë firma e tij si përfaqësues i tyre. Në lidhje me punësimin tek shoqëria “N.V” sh.p.k., subjekti ka deklaruar se ka punuar pranë kësaj shoqërie nga viti 1997 deri në vitin 2005. Ai ka deklaruar se duke qenë në marrëdhënie ndërpersonale me administratorin dhe njërin nga ortakët e kësaj shoqërie, nuk ka qenë asnjëherë i interesuar për të pyetur nëse i paguheshin sigurimet shoqërore dhe ato shëndetësore, përfshirë këtu edhe moshën e re dhe kohën për të cilën bëhet fjalë, me informalitet shumë të lartë. Subjekti ka konfirmuar se momenti i shkëputjes së marrëdhënies së tij me këtë shoqëri ka qenë koha kur i është dashur të aplikojë për kreditë për blerjen e apartamentit në të cilin banon dhe që i është kërkuar dokumentacioni ligjor nga banka Societe Generale Albania, ku punonte dhe bashkëshortja

e tij, pasi nga ortakët e kësaj shoqërie nuk ishte bërë i mundur rregullimi i marrëdhënies së punës konform ligjeve në fuqi.

**18.10.18** Ai ka deklaruar se pagesa në këtë shoqëri ka qenë ajo bazë, në masën 50.000 lekë, si dhe përqindjet të cilat i llogariteshin në varësi të shitjeve që kishte kjo shoqëri. Për të vërtetuar këtë marrëdhënie, subjekti ka depozituar një deklaratë nga administratori i shoqërisë “N.V” sh.p.k., shtetasi P.K. Në lidhje me punësimin pranë shoqërisë “A.C” sh.p.k., subjekti ka sqaruar se ka zgjatur 3 vjet dhe, pas mosmarrëveshjeve që ka pasur me administratorin e kësaj shoqërie, shtetasin grek K.V (i cili ka ndërruar jetë), për mënyrën dhe masën e pagesës, është larguar me dëshirën e tij. Ai ka deklaruar se pagesa në këtë shoqëri ka qenë në masën 100.000 lekë, por në organet tatimore i është dokumentuar vetëm pagesa minimale në shkallë vendi. Subjekti në vijim të shpjegimeve ka deklaruar se të gjitha pasuritë e tij dhe bashkëshortes janë krijuar: (i) para fillimit të detyrës si ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit; (ii) me burime të ligjshme (të ardhurat nga pagat dhe kreditimet nga banka); (iii) ka arritur të sigurojë prova të tërthorta, me anë të të cilave provon faktin se ka qenë në marrëdhënie punë dhe ka përfituar të ardhurat e deklaruara.

**18.10.19** Subjekti mbi këto shpjegime është shprehur se ka arritur të provojë dhe të krijojë bindjen para Komisionit se të ardhurat e deklaruara gjatë kësaj periudhe janë të ligjshme dhe duhet të konsiderohen në analizën financiare dhe, për pasojë, balanca për këtë periudhë rezulton pozitive.

**18.10.20** Trupi gjykues, në analizë të fakteve dhe rrethanave të rezultuara për këtë çështje, shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të depozituar për të provuar të kundërtën e konstatimeve, konstaton se subjekti ka bërë përpjekje për të siguruar dokumentacion mbështetës goftë edhe jo të drejtpërdrejtë lidhur me punësimin e tij dhe pagesat e marra nga shoqëritë punëdhënëse, në ndryshim nga të dhënat e pasqyruara në vërtetimin e punësimit. Më konkretisht, sipas deklaratës noteriale të shoqërisë “N.V” sh.p.k.<sup>29</sup>, administratori i saj deklaroi se z. Spartak Mitrushi ka punuar pranë kësaj shoqërie dhe se është paguar me pagë bazë mujore 50.000 lekë në muaj. Gjithësesi, kjo vlerë mbetet në nivel deklarativ nga punëdhënësi, i cili ka qenë përgjegjës për konfirmimin e saj nëpërmjet pagesave të sigurimeve që duhet të ishin kryer sipas legjislacionit përkatës dhe, për pasojë, nuk konsiderohet në favor të subjektit si një e ardhur që përkon me kërkesën e nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Nga ana tjetër, trupi gjykues konsideron disa faktorë të tjerë, të cilët, të vlerësuar në harmoni me njëri-tjetrin, krijojnë bindjen se subjekti ka siguruar të ardhura në punësimin e tij pranë kësaj shoqërie, por edhe pranë shoqërisë “A.C” sh.p.k., pasi në këtë çështje objekt vlerësimi nga hetimi ka rezultuar se shoqëria “N.V” sh.p.k. (e krijuar prej vitit 1997 sipas ekstraktit të QKB-së, depozituar nga subjekti me prapësime) ka pranuar të deklarojë pagesën reale dhënë subjektit, duke pranuar kështu edhe përgjegjësinë e saj për pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si detyrim i punëdhënësit, duke përjashtuar nga kjo përgjegjësi përfituesin e të ardhurave/subjektin e rivlerësimit. Po ashtu, edhe shoqëria tjetër punëdhënëse “A.C” sh.p.k., e cila rezulton e krijuar që në vitin 2003 sipas ekstraktit të QKB-së,

---

<sup>29</sup> Nr. \*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë 8.11.2024, administruar në dosjen e Komisionit.



depozituar nga subjekti në prapësime, ka konfirmuar punësimin e subjektit nëpërmjet vërtetimit<sup>30</sup> të lëshuar prej administratorit të saj që në depozitim e deklaratës *Vetting*.

**18.11** Për sa më sipër arsyetuar, trupi gjykues duke mbajtur në konsideratë disa fakte, si: i) kohën e punësimeve nga subjekti i rivlerësimit kur hera herës individët janë gjendur dhe kanë mësuar për detyrime të papaguara nga subjektet punëdhës, ii) të dhënat e përfituara nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit se ai ka punuar pranë dy shoqërive “N.V” dhe “A.C Shpk”, iii) pozitën e tij /mosqënien subjekt deklarimi në kohën e krijimit të këtyre të ardhurave të cilat kanë ndikuar në balancën negative, v) vetëpranimin e punëdhënësit/shoqëria N.V shpk<sup>31</sup> për pagën bazë mujore të miratuar për subjektin në vlerën 50 000 lekë, për mosdeklarimin e subjektit si punëmarrës në organet tatimore si dhe për moskryerje të pagesave të sigurimeve sipas ligjit, vi) identifikimin e subjektit në sistemin TIMS, si drejtuesi i dy mjeteve të tipit *kamion* në pronësi të punëdhënësit<sup>32</sup>, si tregues i marrëdhënies së punësimit, vii) logjikën e përdorur nga subjekti i rivlerësimit se përpjestimi matematikor i balancës negative i shpërndarë në pesë vite do të rezultonte në një pagë 35000 lekë në muaj e përafshuar kjo me minimumin jetik, - arrin në konkluzion se në këtë çështje objekt vlerësimi përfitohen të dhëna të mjaftueshme që krijojnë bindjen se subjekti ka punuar në këto kompani. Elementet e mosprovueshmërisë së tyre/të ardhurave sipas kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, në vlerësimin e trupit gjykues duhen çmuar nën dritën e objektivitetit dhe proporcionalitet, që në raport me tërësinë e fakteve të tjera të dala, vlerësohen të pamjaftueshëm për aplikimin e një mase penalizuese për subjektin, për efekt të këtij procesi në përmbushje të qëllimit të ligjit nr.84/2016.

**19. Apartament banimi me sipërfaqe 54,4 m<sup>2</sup>**, ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Fier, me burim nga kontrata e pjesëtimit vullnetar, në datën 28.4.2004. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente<sup>33</sup>.

**19.1** ILDKPKI-ja në raportin e tij është shprehur: *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Fier.*

### **Hetimi i Komisionit**

**19.2** Apartamenti i banimit me sipërfaqe 54,4 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Fier, është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit për herë të parë në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës, në vitin 2013. Burimi i krijimit: Trashëgimi nga familja, 100% pjesë takuese, në vlerën 0 (zero) lekë. Në deklaratën e pasurisë *Vetting* 2017, subjekti ka deklaruar burim të krijimit të pasurisë nga kontrata e pjesëtimit vullnetar, datë 28.4.2004, pjesa takuese 100%, vlera 0 (zero) lekë.

---

<sup>30</sup> Datë 24.1.2017, depozituar nga subjekti në ILDKPKI dhe në datën 1.11.2024, depozituar nga subjekti në prapësime, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>31</sup> Me deklaratën notoriale nr.\*\*\* rep, nr.\*\*\* kol, datë 8.11.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>32</sup> të konfirmuara nga DPSHTRR me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 14.10.2024, akt i depozituar me përgjigjet e pyetësorin nr.3, date 9.10.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>33</sup> Kontratë pjesëtimi vullnetar nr. \*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë 28.4.2004, për apartamentin me sip. 54,4 m<sup>2</sup> me nr. pasurie \*\*\*, me palë shtetasit P.G.M dhe Spartak G. Mitrushi, si dhe kartela e pasurisë. Certifikatë pronësie e ZVRPP Fier, datë lëshimi 18.10.2006, për apartamentin sip. 54.4 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, z. k. \*\*\*, në emër të shtetasit Spartak Mitrushi, si dhe harta treguese (aneks nr. 4/3, administruar në dosjen e ILDKPKI-së).

**19.3** ZQRPP-ja<sup>34</sup> ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP Fier, e cila konfirmon se në emër të subjektit Spartak Mitrushu figuron e regjistruar pasuria apartament me sipërfaqe 54,4 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, z. k. \*\*\*, Fier, pasuri e regjistruar sipas kontratës së pjesëtimit vullnetar. Bashkëlidhur edhe certifikata e pronësisë në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Spartak Mitrushu.

**19.4** Nga dokumentacioni i depozituar Komisioni konstatoi se kjo pasuri është përfituar fillimisht nga privatizimi i banesave në vitin 1993<sup>35</sup>. Sipas kontratës së shitjes<sup>36</sup> datë 18.3.2004, shtetasit G dhe A.M u shesin apartamentin me sipërfaqe 109,81 m<sup>2</sup>, në shumën 200.000 lekë, shtetasve Spartak dhe P.M (prindërit u shesin pjesën e tyre takuese fëmijëve me të cilët janë bashkëpronarë të apartamentit, sepse kur është bërë privatizimi i banesës në certifikatën familjare rezultonin prindërit A dhe G.M dhe 2 djemtë e tyre P dhe Spartak Mitrushu). Shtetasit Spartak dhe P.M, sipas kontratës së pjesëtimit vullnetar<sup>37</sup> kanë kryer pjesëtimin e pasurisë duke përfituar secili gjysmën e apartamentit, si dhe kanë regjistruar në emër të tyre pjesët takuese.

**19.5** Subjekti<sup>38</sup> ndër të tjera ka shpjeguar se apartamenti është përfituar nga privatizimi i banesave në vitin 1993. Në momentin e privatizimit të apartamentit, i cili përbëhej nga dy banesa së bashku, në certifikatën familjare bashkë me të kanë rezultuar prindërit e tij A dhe G.M, si dhe vëllai i tij P.M. Pas martesës së vëllait të tij P.M, prindërit kanë vendosur që pjesën e tyre tua lënë dy djemve bashkëpronarë të apartamentit. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në vitin 2022 apartamentin ia ka dhuruar motrës së tij A.M dhe për të provuar këtë fakt ka depozituar kontratën e dhurimit<sup>39</sup>. Nga verifikimi përkatës duket se përputhet deklarimi i subjektit me aktin e depozituar.

**19.6** Subjekti ka depozituar<sup>40</sup> librezën e FSHU-së për këtë pasuri. Komisionit nga verifikimi i dokumentit i rezultoi se për këtë pasuri ka pasur kontratë shërbimi të energjisë elektrike, e cila ka vijuar të jetë në emrin e nënës së subjektit.

**19.7** Për sa arsyetohet më sipër, Komisionit nuk i rezultuan problematika lidhur me ekzistencën dhe burimin e ligjshëm të kësaj pasurie.

**20. Tokë arë me sipërfaqe 1.250 m<sup>2</sup>, ndodhur në P, Tiranë,** blerë me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.11.2010, me vlerë 312.500 lekë. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: Kredi në Societe Generale Albania, në shumën 33.000 euro, sipas kontratës nr. 19646, datë 21.12.2010. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente<sup>41</sup>.

---

<sup>34</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.9.2017, ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Fier nr. \*\*\* prot., datë 18.9.2017, e cila konfirmon se në emër të shtetasit Spartak Mitrushu figuron e regjistruar pasuria apartament me sip. 54,4 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\* z. k. \*\*\*, Fier, pasuri e regjistruar sipas kontratës së pjesëtimit vullnetar, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 28.4.2004 (aneks nr. 28, administruar në dosjen e ILDKPKI-së).

<sup>35</sup> Kontrata e privatizimit datë 1.9.1993 e banesës me adresë - b. \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\* dhe \*\*\*, kati\*\*\*, lagjja "\*\*\*\*\*", rruga "\*\*\*\*\*", Fier (aneks nr. 28, administruar në dosjen e ILDKPKI-së).

<sup>36</sup> Kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 18.3.2004, me palë shitëse shtetasit A dhe G.M dhe palë blerëse shtetasit P dhe Spartak Mitrushu (aneks nr. 28, administruar në dosjen e ILDKPKI-së).

<sup>37</sup> Kontratë pjesëtimi vullnetar nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 28.4.2004, për apartamentin me sip. 54,4 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, me palë shtetasit P.G.M dhe Spartak G. Mitrushu (aneks nr. 4/3, administruar në dosjen e ILDKPKI-së).

<sup>38</sup> Me pyetësorin nr. 2, datë 6.9.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>39</sup> Kontratë dhurimi datë 14.6.2022, depozituar në përgjigje të pyetësorit nr. 2, datë 6.9.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>40</sup> Me pyetësorin nr. 3, datë 9.10.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>41</sup> Certifikatë pronësie e ZVRPP-së Tiranë, datë lëshimi 4.12.2010, e pasurisë arë me sip. 1.250 m<sup>2</sup>, në P, Tiranë, me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, në emër të shtetasve Spartak G. Mitrushu dhe K.F.M, kartela e pasurisë - shuma e paguar 312.500 lekë, si dhe harta

**20.1** ILDKPKI-ja në raportin e tij është shprehur se: Lidhur me pasurinë tokë arë në P, Tiranë me sip. 1.250 m<sup>2</sup>, blerë në vitin 2010 në vlerën 312.500 lekë, ose 250 lekë/m<sup>2</sup>, konstatohet se ky çmim është nën vlerën e tregut për periudhën dhe se zona është në zhvillim dhe me kërkesa në rritje, të vazhdueshme prej vitesh. Për rrjedhojë rezultoi: vlerë e dyshimtë/deklarim i rremë i blerjes së tokës arë me sipërfaqe 1.250 m<sup>2</sup>, me vlerë 312.500 lekë, ose 250 lekë/m<sup>2</sup>, e shoqëruar kjo edhe me evazion fiskal lidhur me shlyerjen e detyrimeve ndaj shtetit për tatimin në burim, pasi: (a) për blerjen e tokës është marrë kredi në shumën 35.000 euro; (b) sipas konfirmimit të Societe Generale Albania, për kredinë në shumën 35.000 euro është vendosur garanci toka arë me sipërfaqe totale 1.250 m<sup>2</sup>, e ndodhur në z. k. \*\*\*, me nr. pasurie \*\*\*, e ndodhur në P, Tiranë, vlerësuar 50.000 euro me vlerë tregu dhe 40.000 euro me shitjen e menjëhershme.

### **Hetimi i Komisionit**

**20.2** Pasuria tokë arë me sipërfaqe 1.250 m<sup>2</sup>, ndodhur në P, Tiranë, është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit për herë të parë në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës në vitin 2013, me përshkrimin “Tokë arë me sipërfaqe 1.250 m<sup>2</sup>, P, Tiranë. Vlera: 312.500 lekë. Burimi i krijimit: Kredi nga SGAL 33.000 euro”.

**20.3** ZQRPP-ja<sup>42</sup> ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Tiranë<sup>43</sup>, e cila informon se shtetasit Spartak Mitrusi dhe K.M kanë të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme pasurinë nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, z. k\*\*\*\*, të llojit arë me sipërfaqe 1.250 m<sup>2</sup> (pasuri aktive). Në seksionin e hipotekave është regjistruar kontratë hipotekimi për bankën Societe Generale Albania.

**20.3.1** Kjo drejtori ka vendosur në dispozicion dosjen e plotë të kësaj pasurie, ku nga analizimi i dokumentacionit rezultoi se:

i. Pasuria është përfituar nëpërmjet kontratës së shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.11.2010, me palë shitëse shtetasit S, L, A dhe O.D dhe palë blerëse shtetasit Spartak dhe K.M. Me marrëveshje të përbashkët, çmimi i shitjes është caktuar 250 lekë/m<sup>2</sup>, në vlerë totale 312.500 lekë. Likuidimi i çmimit të shitjes është bërë totalisht nga pala blerëse jashtë zyrës së noterisë.

ii. Sipas kartelës së pasurisë, toka arë është regjistruar në datën 4.12.2010 në emër të shtetasve Spartak G. Mitrusi dhe K.F.M.

iii. Kjo pasuri është vendosur kolateral për kredinë e marrë në OTP Bank (ish-Societe Generale Albania) në shumën 33.000 euro.

### **20.4 Lidhur me burimin e krijimit për këtë pasuri**

**20.4.1** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën periodike, por edhe në atë *Vetting*, se burim krijimi për këtë pasuri ka shërbyer kredia në Societe Generale Albania, në shumën 33.000 euro.

---

treguese. Kontratë shitjeje pasurie e paluajtshme, tokë arë, nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol., datë 17.11.2010, me vlerë 312.500 lekë. Palë shitëse shtetasit S, L, A dhe O.D dhe palë blerëse shtetasit Spartak dhe K.M, si dhe certifikata e pasurisë dhe harta treguese bashkëlidhur, në emër të shitësit S.D. Lidhur me mënyrën e pagesës, kontrata citon: “*Pagesa 312.500 lekë likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale*” (aneks nr. 4/4, administruar në dosjen e ILDKPKI-së).

<sup>42</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.2.2018 (aneks nr. 29 në dosjen e ILDKPKI-së)

<sup>43</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2018 (aneks nr. 29 në dosjen e ILDKPKI-së).

**20.4.2** OTP Bank informon<sup>44</sup> se shtetasja K.F.M ka marrë kredi në monedhën euro, hapur në datën 6.1.2011, në shumën 33.000 euro, me datë mbylljeje 8.1.2026. Banka ka përcjellë kontratën e kredisë afatgjatë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.12.2010, me palë huamarrëse shtetasit K.M dhe Spartak Mitrushit (garantor), në shumën 33.000 euro, me qëllim për blerje toke. Kolateral për këtë kredi është vendosur pasuria e paluajtshme objekt vlerësimi, tokë arë me sipërfaqe 1.250 m<sup>2</sup>, regjistruar me nr. pasurie \*\*\*, zonë kadastrale \*\*\*, me adresë fshati P, Tiranë.

**20.4.3** Nga analizimi i llogarisë së kredisë rezulton se kredia në fjalë është disbursuar në datën 6.1.2011 dhe në datën 7.1.2011 është transferuar shuma 32.600 euro në llogari të shtetases A.D (një nga shitësit e pasurisë).

**20.4.4** Për sa rezultoi më sipër, por edhe për sa kohë kjo kredi është akorduar nga një institucion financiar, duket se nuk konstatohet ndonjë problematikë lidhur me ligjshmërinë e këtij burimi.

**20.5** Lidhur me vlerën reale të blerjes së kësaj pasurie, Komisioni konstatoi se:

i) Kredia është disbursuar në datën 6.1.2011, ndërkohë që kontrata e shitblerjes së tokës arë është nënshkruar në datën 17.11.2010, rreth 1 muaj e gjysmë para marrjes së kësaj kredie, e cila ka pasur për qëllim realizimin e kësaj blerjeje.

ii) Vlera e marrë kredi prej 33.000 euro nuk korrespondon me çmimin e përcaktuar në kontratën e shitjes prej 312.500 lekësh.

iii) Për kredinë në shumën 33.000 euro është vendosur hipotekë mbi këtë pasuri të llojit tokë arë, e cila është vlerësuar nga eksperti i pasurive të paluajtshme, vlerësues i shkallës së parë, i kontraktuar nga banka, në shumën 50.000 euro me vlerë tregu dhe 40.000 euro me shitjen e menjëhershme.

**20.6** Komisioni i kërkoi<sup>45</sup> subjektit të rivlerësimit të shpjegojë dhe dokumentojë lidhur me mospërputhjet e konstatuara, si dhe të sqarojë vlerën reale të shpenzuar për këtë pasuri.

**20.7** Subjekti në përgjigje ka sqaruar: *“Shitësit e tokës i kishim njerëz të njohur. Në këto kushte, kontrata është nënshkruar në marrëdhënie mirëbesimi, pasi shitësit ishin në dijeni që kredia për blerje toke ishte miratuar nga banka dhe mbetej vetëm koha për kryerjen e procedurave të kontratave dhe bllokimeve hipotekore para se të disbursohet kredia dhe t’u kalohej fondi”.*

**20.8** Subjekti ka depozituar 2 kontrata të ngjashme<sup>46</sup> lidhur me blerjen e së njëjtës lloj pasurie, në të njëjtën vendndodhje, por me kohë të ndryshme. Gjithashtu, ai ka sqaruar se: *“Për sa i përket vlerës së kredisë, është marrë në vlerë më të madhe se vlera e blerjes së tokës, pasi është përdorur dhe për disa investime të vogla në tokë të tipit rrethime, sistemime, drenazhim, mbjellje pemësh etj.”*

**20.9** Lidhur me vlerësimin e pasurisë, subjekti ka sqaruar: *“Vlerësuesi është i kontraktuar nga banka dhe ka kryer vlerësimin e pasurisë për llogari të bankës, me qëllim vendosjen e pronës*

<sup>44</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.8.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>45</sup> Me pyetëtorin nr. 2, datë 6.9.2024 dhe nr. 3, datë 9.10.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>46</sup> Kontratë noteriale datë 23.11.2011 e noteres F.SH dhe kontratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 1.2.2019, e noteres A.P, në përgjigje të pyetëtorit nr. 2, datë 6.9.2024, administruar nga Komisioni.

*kolateral në favor të bankës. Nuk di të jap shpjegime për metodën që përdorin vlerësuesit në vlerësimin e pasurive të paluajtshme për efekt kolaterali për bankën”.*

**20.10** Në lidhje me vlerën reale të tokës, subjekti ka sqaruar: “...Vlera e paguar nga ana ime është e barasvlershme me vlerën e transferuar në llogarinë bankare të shtetasës A.D, nga të cilat 30.000 euro kanë shkuar për pagesën e vlerës së tokës dhe pjesa tjetër e mbetur ka shkuar për rregullime, sistemimet, drenazhimin dhe rrethimin e kësaj prone, të cilat janë bërë në mënyrë periodike gjatë disa viteve”. Për të konfirmuar sa më sipër, subjekti ka depozituar një deklaratë noteriale nga shtetasja A.D në cilësinë e vajzës së shitësve, për të cilën ka sqaruar se i ati/shitësi ka ndërruar jetë dhe e ëma ndodhet në kushte të vështira shëndetësore. Në vijim, subjekti ka deklaruar: “Këto punime konsistojnë në mbjelljen e disa pemëve të llojit dardhë në pjesën veriore të pronës dhe shërbejnë edhe si kufizim i pronës sime me atë të fqinjit tim, në anën veriore. Në anën lindore të kësaj prone është sistemuar me tombino vendkalimi i përroit, që bën të mundur hyrjen në pronën time. Gjithashtu, është shtruar me një shtresë çakulli dhe është drenazhuar rruga nga prona ime deri te rruga kryesore, e cila është në distancë rreth 200 metra. Këto punime janë kryer nga fqinji im S.D, i cili ishte dhe shitësi i kësaj prone dhe, duke qenë me profesion agronom dhe banor rezident aty, kujdesej edhe për këtë pronë me shërbime të ndryshme. Në lidhje me çmimin në kontratë është vendosur vlera prej 312.500 lekësh, edhe sipas çmimit të referencës, sikundër e provova dhe me kontratat e ngjashme të paraqitura në cilësinë e provës. Sqaroj se duke dashur të jem korrekt në deklarinimin tim sipas dokumentacionit, kam deklaruar si çmim atë të vendosur në kontratë, por pa mohuar që kredia e marrë ka shërbyer si burim krijimi për këtë pasuri. Sjell në vëmendjen tuaj se kjo kontratë është lidhur para fillimit të detyrës time si ndihmës ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit, dhe nuk u kam kushtuar interesin e duhur efekteve negative që do të sillte më pas, por për hir të miqësisë që kishim me shitësin dhe pas insistimit në kërkesën e tyre kam pranuar që në kontratë të vendosej vlera sipas çmimit të referencës së asaj zone kadastrale”.

**20.11** Komisioni kreu analizën financiare për blerjen e kësaj toke arë, në vitin 2011, për vlerën 32.600 euro, nga ku nuk rezultuan problematika.

**20.12** Pas përlllogaritjeve, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit: (i) ka deklaruar saktë burimin e krijimit të pasurisë, e cila u provua se është kredia e marrë në OTP Bank; (ii) çmimi i shitjes i paguar nga subjekti i rivlerësimit prej 30.000 euro përkon edhe me vlerësimin e kryer nga eksperti i pasurive të paluajtshme, vlerësues i shkallës së parë, i kontraktuar nga banka, në shumën 50.000 euro me vlerë tregu dhe 40.000 euro me shitjen e menjëhershme.

**20.13** Ndërkohë, Komisioni konstatoi se dukej se me veprimin e kryer subjekti kishte favorizuar shitësin e kësaj pasurie me qëllim shmangien e këtij të fundit nga pagesa e tatimit mbi të ardhurat. Në këto kushte, Komisioni<sup>47</sup> i kërkoi subjektit të jepte shpjegime bindëse.

---

<sup>47</sup> Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

## Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

**20.14** Subjekti në parashtrimet e tij i është referuar legjislacionit civil, si dhe vendimeve të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë<sup>48</sup> lidhur me fiktivitetin apo simulimin e veprimit juridik (kontratë).

**20.15** Subjekti në shpjegimet e tij ka analizuar duke iu referuar përmbajtjes së këtyre vendimeve. Ai ka sqaruar se nëse do të rezultonte se pasuria e padeklaruar në deklaratë dhe e konstatuar pas hetimit nga organet kompetente, sikurse është ILDKPKI-ja, nuk justifikohet me burime të ligjshme, atëherë do të ishim përpara fshehjes së pasurisë dhe jo përpara deklarimit të rremë. Subjekti ka analizuar edhe mbi të qenët përpara deklarimit të rremë. Sipas tij *do të ishim përpara deklarimit të rremë të pasurisë që është pasqyruar në deklaratë nga subjekti i deklarimit, kur funksionari fillon punë dhe bëhet subjekt i deklarimit të pasurisë, ai deklaroi më tepër pasuri sesa ka, në mënyrë që më vonë të mund të justifikojë shtimin e saj nga ndonjë veprim i mundshëm korruptiv dhe jo të lërë pa deklaruar pasuri që janë përfituar në mënyrë të ligjshme. Gjithashtu, do të ishim përpara deklarimit të rremë të pasurisë, të pasqyruar në deklaratën e pasurisë nëse subjekti i deklarimit pasqyron si fakt fitimin e një pasurie nëpërmjet dhurimit, ndërkohë që provohet që ky akt është fiktiv, pasi realisht subjekti e ka blerë nga burime të paligjshme, si dhe rastet kur subjekti i deklarimit deklaroi blerjen e një pasurie në një vlerë më të vogël sesa vlera reale e blerë apo shitjen e një pasurie me një vlerë më të lartë se vlera reale e shitur etj.*

**20.16** Më tej, subjekti në analizën e tij të fokusuar po tek nocioni i deklarimit të rremë ka shpjeguar lidhur me dallimin që duhet bërë sipas tij, midis deklarimit të rremë të pasurisë që është pasqyruar në deklaratën e pasurisë nga subjekti i deklarimit, nga gabimet materiale, pasaktësitë, plotësimet e gabuara dhe parregullsitë që evidentohen në deklaratë, për shkak të neglizhencës, harresës apo për shkak të paqartësisë së plotësimin të deklaratës së pasurisë, që vjen nga mungesa e trajnimit nga organet kompetente. Në këtë kontekst, subjekti ka zgjeruar analizën dhe shpjegimet e tij, duke iu referuar legjislacionit mbi të cilin ushtron funksionin ILDKPKI-ja<sup>49</sup>, masave administrative që

---

<sup>48</sup> Nr. 932, datë 22.6.2000, ku ndër të tjera arsyetohet: “Në rastet e fiktivitetit dhe të simulimit mospërputhjen midis vullnetit dhe shfaqjes së tij e duan vetë palët e veprimit juridik. Veprimi juridik është i simuluar kur kryhet me qëllim që të mbulojë një veprim tjetër juridik të vlefshëm apo të pavlefshëm, te cilin palët kanë dashur ta kryejnë me të vërtetë dhe që rezultojnë prej kundërdeklarimit si marrëveshje e fshehtë midis tyre”. Ndërsa në vendimin nr. 8, datë 26.3.2004, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ndër të tjera arsyetohet: “Sa më sipër, Kolegjet çmojnë se kontratat e shitjes së kryera mes palëve të sipërcituara kanë prodhuar pavlefshmëri absolute, pasi ka rezultuar mungesa e vullnetit të palëve pjesëmarrëse në veprimet juridike të kryera për krijimin, ndryshimin, shuarjen e të drejtave dhe detyrimeve juridike civile. Vullneti i palëve është rezultat i përpunimit të deklarimeve të vullnetit. Në rastin konkret, vullneti i jashtëm i deklaruar nga palët prodhon efekte juridike jo për faktin se fjalët e caktuara thuheshin ose shkruhen në kontratë, por në qoftë se deklarimi i jashtëm i korrespondon vullnetit të brendshëm të deklaruesit për kryerjen e veprimeve juridike të caktuara. Siç është provuar në gjykim dhe e argumentuar drejt nga gjykata në vendim, në rastin konkret ka munguar vullneti i brendshëm i palëve, për të prodhuar pasojat juridike me veprimet juridike të kryera, të cilat më të drejte janë konstatuar të pavlefshme, duke u shprehur gjykata edhe për zgjidhjen e pasojave”.

<sup>49</sup> Ndër të tjera, ka referuar nenin 24 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, i ndryshuar, nën titullin “Përpunimi paraprak” parashikohet shprehimisht se: “Inspektorati i Lartë bën përpunimin paraprak të deklarimeve, i cili përfshin juridiksionin, rregullsinë e plotësimin të deklaratës dhe të anekseve të saj. Kur nga përpunimi paraprak vërtetohen gabime materiale ose plotësime të gabuara, Inspektorati njofton subjektin që ka paraqitur këto deklarime, i cili brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit është i detyruar t’i ndreqë ato. Deklaratat e interesave privatë pas dorëzimit dhe regjistrimit kalojnë menjëherë në skanimin fizik dhe ruhen në sistemin e programuar elektronik të ILDKPKI-së. Vetëm pas përfundimit të procedurave të skanimit deklaratat e interesave privatë kalojnë në përpunimin paraprak, kontrollin aritmetik e logjik dhe, më pas, në kontroll të plotë. Procedurat e pranimit, skanimit dhe përpunimit paraprak miratohen nga Inspektori i Përgjithshëm”. Ndërsa në nenin 25 të këtij ligji nën titullin “Llojet e kontrollit”, parashikohet se: “1. Kontrolli i deklarimeve përfshin kontrollin, aritmetik e logjik dhe verifikimin e miratimit e të dhënave të deklaratës (kontrolli i plotë). Kontrollin, aritmetik dhe logjik, kryhen për çdo deklarim për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të

ndërmerr ky institucion në rast shkeljesh të konstatuara etj. Subjekti gjithashtu ka analizuar mbi përmbajtjen e nenit 40 të ligjit nr. 9049/2003, përfshirë edhe ndryshimet e dispozitës në vijim.

**20.17** Pas analizës ligjore të bërë, subjekti shprehet se në vlerësimin e tij pasaktësitë që lidhen edhe me mosplotësimin si duhet të deklaratës së pasurisë, ku përfshihen rastet e mosdeklarimit të plotë të pasurisë së ligjshme, si dhe gabimet materiale apo pasaktësitë e ndryshme në lidhje me burimin e krijimit të pasurive, vlerën e asetëve në deklaratën e pasurisë, nuk përbëjnë kundërvajtje administrative dhe, për rrjedhojë, nuk kanë se si të përbëjnë vepër penale në formën e fshehjes dhe/apo të deklarimit të rremë të pasurisë.

**20.18** Subjekti sqaron se provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se ai si subjekt rivlerësimi ka burime të ligjshme për të justifikuar pasuritë në pronësi të tij dhe të bashkëshortes, si subjekt deklarues të pasurive sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, të ndryshuar.

**20.19** Ai ka konfirmuar mbi dorëzimin në kohë dhe sipas ligjit pranë ILDKPKI-së të deklaratës së interesave private para fillimit të detyrës. Po ashtu, ai ka sqaruar e analizuar edhe mbi nocionin e “burimit të ligjshëm të krijimit të pasurive”, në funksion të zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi, duke iu referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, konkretisht nenit 4 të këtij ligji<sup>50</sup>. Në kuptim të dispozitave, subjekti deklarues duhet të provojë se si burim i krijimit të të ardhurave që do të konsiderohen të ligjshme duhet të jete një nga marrëdhëniet e përshkruara në nenin 4 të ligjit nr. 8438/1998 ose ndonjë forme tjetër, e cila jo vetëm nuk është e ndaluar nga legjislacioni, por duhet njëkohësisht të ketë një parashikim ligjor

---

*pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara. Verifikimi e miratimi i të dhënave të deklaratës (kontroll i plotë) bëhen për ato deklarime, të cilat, nga kontrollat e përcaktuara në piken 1 të këtij neni, paraqesin probleme, papajtueshmëri dhe parregullsi në justifikimin e burimeve të mbulimit të pasurisë ose në pasurinë e deklaruar dhe në deklarime të tjera, sipas skemës së kontrollit. Në kuptim të këtij ligji, janë parregullsi në justifikimin e burimeve rastet kur burimet dhe pasuritë e krijuara nuk përputhen për shumën mbi 1.000.000 lekë për deklarimet vjetore dhe për shumën mbi 2.000.000 lekë për deklarimet e bëra sipas neneve 6 dhe 9 të këtij ligji. Skema e kontrollit të deklarimeve duhet të përfshijë kontrollin e plotë të deklaratave jo më pak se një herë në dy vjet. 2. Verifikimi dhe kontrolli i pasurisë, i detyrimeve financiare kryhet i plotë, për çdo vit, për Presidentin e Republikës, Kryetarin e Kuvendit, Kryeministrin, zëvendëskryeministrin, ministrat dhe drejtuesit, funksionet e të cilëve barazohen me ta. 3. Metodikat dhe manualët e ushtrimit të kontrollit miratohen nga Inspektori i Përgjithshëm”; nenin 40 të po këtij ligji etj.*

<sup>50</sup> Nën titullin “Burimi i të ardhurave” parashikohet shprehimisht se: “Të ardhurat nga një burim në Republikën e Shqipërisë, pa u kufizuar vetëm në to, do të përfshijnë të ardhurat si vijon: a) Të ardhurat nga marrëdhënia e punës së ushtruar në Republikën e Shqipërisë; b) të ardhurat nga veprimtari kulturore apo sportive, si dhe nga veprimtari të tjera, personale në Republikën e Shqipërisë; c) të ardhurat nga veprimtaria e zhvilluar nga një person jorezident, nëpërmjet një personi me seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë; d) të ardhurat nga kalimi i se drejtës së pronësisë mbi sendet e paluajtshme, që i përfiton një person me seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë; dh) të ardhurat nga: i) pasuria e paluajtshme, aksesorët dhe frytet e tyre, si dhe të ardhurat që rrjedhin nga të drejtat mbi pasuritë e paluajtshme që ndodhen në Republikën e Shqipërisë; ii) të drejtat për shfrytëzimin e pasurive minerale, të drejtat për shfrytëzimin e pasurive hidrokarbure ose të drejta të tjera për shfrytëzimin e burimeve natyrore tokësore dhe ujore, përfshirë detin në Republikën e Shqipërisë, si dhe informacionit që u përket këtyre të drejtave; Të drejtat dhe informacioni i përmendur në nënndarjet “i” dhe “ii”, më sipër, për qëllime të këtij ligji, trajtohen si pasuri e paluajtshme; e) të ardhurat nga tjetërsimi i: i) pasurisë, të drejtave dhe informacionit të përmendur në shkronjën “dh” të këtij neni; ii) aksioneve ose interesave të ngjashëm, të tillë si interesat në ortakëri ose truste, sipas përkufizimeve në legjislacionet përkatëse, kudo që ndodhen, në qoftë se në çdo kohë gjatë 365 ditëve para tjetërsimit, këtyre aksioneve ose interesave të ngjashëm u buron më shumë se 50 për qind e vlerës direkt ose indirekt nga pasuria e paluajtshme, të drejtat ose informacioni, të përmendura në shkronjën “dh” të këtij neni; ë) të ardhurat nga dividendët e shpërndarë nga një person juridik, rezident; f) të ardhurat nga pjesët e fitimit, të paguar nga një ortakëri rezidente; g) të ardhurat nga interesat e paguar nga organet e qeverisjes qendrore apo vendore ose nga një rezident i Republikës së Shqipërisë, ose që paguhet nga një jo rezident, nëpërmjet një personi që ka seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë; gj) të ardhurat nga e drejta e autorit dhe pronësia intelektuale, qiraja dhe enfiteoza; si dhe të ardhurat nga lojërat e fatit; h) të ardhurat e një personi jo rezident, të përfuara si rezultat i shërbimeve të kryera për një person rezident. i) të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen”.

për lejimin e atij lloj aktiviteti. Subjekti, duke u mbështetur në analizën e mësipërme, konkludon se të ardhurën e ligjëron burimi i krijimit, se një e ardhur nuk klasifikohet në sistemin financiar si e paligjshme nëse mbi të nuk janë paguar taksa, për më tepër kur ligji tatimor shqiptar vendos detyrimin për tatimin e të ardhurave të jashtëligjshme. Detyrimi tatimor lind edhe kur personi realizon të ardhura, kryen pagesa në formë të jashtëligjshme ose bëhet zotërues i një sendi në forma të jashtëligjshme. Kur personi bëhet zotërues i një sendi në forma të jashtëligjshme, ky detyrim përlllogaritet për të gjithë periudhën në të cilën personi ka gëzuar frytet e kësaj pasurie. Nga ana tjetër, pagesa tatimore nuk e bën të ardhurën të ligjshme, ajo vazhdon të mbetet e paligjshme, sepse burimi i krijimit është i tillë. Ka një sërë të ardhurash që janë të përjashtuara nga tatimi. Në këtë drejtim, nuk do të kishte sens logjik e juridik nëse ligjshmëria e këtyre të ardhurave do të lidhej me pagesën faktike të tatimit. Pagimi i taksave nuk ligjëron pasurinë/të ardhurën, sikurse mospagimi i taksave nuk e cilëson pasurinë/të ardhurën të paligjshme. Ligjshmëria e pasurisë përgjatë gjithë legjislacionit fiskal të kontrollit të pasurive ose të pastrimit të parave lidhet me burimin e krijimit dhe jo me pagesën tatimore mbi këto të ardhura. Subjekti ka referuar edhe vendime të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit<sup>51</sup>.

**20.20** Subjekti deklaron me bindje se me veprimet e tij nuk ka favorizuar shitësin e kësaj pasurie, me qëllim shmangien e këtij të fundit nga pagesa e tatimit mbi të ardhurat, pasi ai ka qenë një veprim juridik në mirëbesim dhe pa qëllim shmangie të ardhurash.

**20.21** Trupi gjykues, në analizë të fakteve të rezultuara përgjatë hetimit administrativ, shpjegimeve të dhëna nga subjekti, si dhe dokumentacionit të administruar, vlerëson se qëndron konstatimi se në kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie është vendosur një vlerë më e ulët në raport me shumën që ka shërbyer për blerjen e pasurisë. Në këto kushte, së pari, trupi gjykues konkludon se subjekti, edhe pse ka kryer veprimin përpara detyrës, duhet të ishte treguar më i kujdesshëm në përmbajtjen e termave të kontratës, konkretisht në çmimin e vendosur. Por kjo mangësi në vlerësimin e trupit gjykues nuk passjell pasojë për penalizimin e subjektit për efekt të këtij procesi, pasi nga hetimi provohet se ai e ka deklaruar saktësisht burimin e krijimit të blerjes së tokës si në deklaratën *Vetting*, edhe në atë periodike. Ai ka deklaruar kredinë e përfiturar në OTP Bank, në shumën 33.000 euro. Po ashtu, nga verifikimi i të dhënave në kontratën e kredisë datë 6.1.2011, rezulton e parashikuar se qëllimi i kredisë është blerja e kësaj pasurie, e cila është vendosur edhe kolateral për këtë kredi. Nga verifikimi i transaksioneve bankare rezultoi se kredia pas disbursimit ka kaluar në favor të shitësit (njërit prej tyre). Vlera e kredisë krijon bindjen për trupin gjykues se ka shërbyer për blerjen e pasurisë për sa kohë edhe vlerësuesi i bankës ka konkluduar se kjo pasuri do të shitej me vlerën e tregut për 50.000 euro dhe në një shitje të shpejtë në vlerën 40.000 euro. Pra, ajo që mbetet evidente dhe më e pranueshme si vlerë që ka shërbyer për blerjen e pasurisë, është vlera

---

<sup>51</sup> Në vendimin nr. 37, datë 24.11.2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ndër të tjera arsyetohet se: “10.12. Në përfundim të kësaj analize, Kolegji arriti në konkluzionin se pretendimi i Komisionerit Publik lidhur me faktin se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të krijuar shumën prej 18.000 eurosh në vitin 2004, nuk është i saktë. Pavarësisht deklarimeve jo të plota të subjektit në vitet 2003 – 2004 për pasurinë likuiditet, nga leximi dhe analiza logjike e deklarimeve të bëra prej tij, qoftë në DPV-ne e vitit 2004, qoftë në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, në çdo rast subjekti justifikon me burime të ligjshme pasurinë e deklaruar prej tij edhe në versionin e pranuar prej Komisionerit Publik, se ai zotëron me bashkëshorten të gjithë shumën. Në lidhje me këtë çështje, Kolegji nënvizon qëndrimin e tij të konsoliduar tashmë se pasaktësitë në deklaratë periodike, të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi...”



30.000 euro, e përafuar në konkluzionin e ekspertit, dhe jo vlera e pasqyruar në kontratë. Në vlerësim të trupit gjykues, konsiderohen edhe kontratat e ngjashme, të cilat, pavarësisht se datojnë në kohë të ndryshme, duket se pasqyrojnë vlerën e blerjes së tokës në raport me çmimet e referencës së zonës ku ndodhet pasuria objekt hetimi, ashtu sikurse është pasqyruar edhe në kontratën e subjektit të rivlerësimit. Në bazë të këtyre rrethanave faktike, trupi gjykues konstaton se në këtë çështje nuk identifikohen veprime apo mosveprime të subjektit, që të dëshmojnë përpjekje të tij për të mbuluar një qëllim/situatë të vërtetë, të ndryshme nga ajo e deklaruar dhe e provuar përgjatë hetimit. Trupi gjykues këtë çështje, në raport edhe me të dhëna të tjera të vërtetuara gjatë hetimit administrativ, nuk e çmon si shkak penalizues për subjektin e rivlerësimit.

**21. Automjet tip “Mercedes-Benz E 200 CDI”, viti i prodhimit 2005, blerë me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 13.9.2016, me vlerë 900.000 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhura nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor nr. \*\*\*, datë 4.4.2015, në vlerën 1.266.120 lekë dhe nga shitja e automjetit tip “Nissan”, me targë \*\*\*, në vlerën 50.000 lekë, sipas deklaratës noteriale datë 26.4.2013. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente<sup>52</sup>.**

**21.1** ILDKPKI-ja në raport është shprehur: *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR-ja.*

### **Hetimi i Komisionit**

**21.2** Këtë automjet subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë në deklaratën *Vetting*.

**21.3** DPSHTRR-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.7.2021, informon Komisionin se shtetasi Spartak G. Mitrushi ka pasur të regjistruar automjetin me targë \*\*\*. Aktualisht ka të regjistruar automjetin me targë \*\*\*.

**21.3.1** DPSHTRR-ja ka përcjellë dosjen përkatëse, nga verifikimi i së cilës rezultoi se automjeti me targë \*\*\*, tip “Mercedes-Benz”, është blerë me anë të kontratës së shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 13.9.2016, me palë shitëse shtetasin R.S dhe palë blerëse shtetasin Spartak Mitrushi, në vlerën 900.000 lekë. Këtë automjet subjekti nuk e disponon aktualisht, pasi është shitur në vitin 2019, në vlerën 700.000 lekë.

**21.4** Nga verifikimi i të dhënave të marra nga sistemi RNSH<sup>53</sup>, rezulton se janë të regjistruara kontratat noteriale të shitjes dhe blerjes të automjeteve nga shtetasi Spartak Mitrushi.

**21.5** Lidhur me burimin e krijimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për këtë pasuri kanë shërbyer: (i) të ardhurat e përfituara nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor nr. \*\*\* datë 4.4.2015, në vlerën 1.266.120 lekë; (ii) të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit tip “Nissan”, me targë \*\*\*, në vlerën 50.000 lekë, sipas deklaratës noteriale datë 26.4.2013.

---

<sup>52</sup> Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 13.9.2016, për blerje automjeti tip “Mercedes-Benz”, me nr. shasie \*\*\*, me targë të huaj, me vlerë 900.000 lekë. Palë shitëse shtetasi R.S dhe palë blerëse shtetasi Spartak Mitrushi. Certifikatë pronësie automjeti tip “Mercedes-Benz”, me nr. shasie \*\*\*, me targë \*\*\*, datë 13.9.2016, në emër të shtetasit Spartak Mitrushi. Leje qarkullimi e automjetit me targë \*\*\*, datë 13.9.2016, në emër të shtetasit Spartak Mitrushi, si dhe faturë doganore e datës 1.9.2016. Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 26.4.2013, për shitjen e automjetit me targë \*\*\*, për shkrirje skrapit, me çmim 50.000 lekë (aneks nr. 4/5, administruar në dosjen e ILDKPKI-së).

<sup>53</sup> Me shkresën \*\*\* prot., datë 26.7.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

**21.6** Komisioni analizoi secilin nga burimet e cituara nga subjekti dhe i rezultoi si më poshtë detajuar:

**21.6.1** *Lidhur me të ardhurat e përfituara nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor nr. \*\*\*, datë 4.4.2015, në vlerën 1.266.120 lekë*

**21.6.1.i** Për këto të ardhura, subjekti i rivlerësimit ka depozituar vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, i cili ka marrë formë të prerë me vendimin e Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë nr. \*\*\*, datë 4.4.2015. Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë, duke ndryshuar vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë nr. \*\*\*, datë 10.9.2014, i ka dhënë të drejtë subjektit për të përfiturar dëmshpërblimin për prishje të kontratës së punës në mënyrë të njëanshme nga M.D.

**21.6.1.ii** Nga analizimi i *statement*-it rezulton se subjektit i është transferuar në llogarinë e tij bankare në BKT Bank, në datën 10.6.2015, shuma 1.266.120 lekë nga Drejtoria e Shërbimit të Provës, me përshkrimin “Për ekzekutim vendimi gjyqësor”.

**21.6.1.iii** Për sa më sipër, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, për sa kohë ato burojnë nga ekzekutimi i një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

**21.6.2** *Lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit tip “Nissan”, me targë \*\*\*, në vlerën 50.000 lekë*

**21.6.2.i** Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar pronësinë mbi këtë automjet për herë të parë në deklaratën para fillimit të detyrës, viti 2013, me përshkrimin “Automjet Nissan Primera, viti i prodhimit 1995, vlera 1.000 euro”.

**21.6.2.ii** DPSHTRR-ja<sup>54</sup> ka përcjellë dosjen përkatëse, nga ku rezulton se me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.1.2005, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shtetasi V.K automjetin tip “Nissan” në vlerën 150.000 lekë.

**21.6.2.iii** Nga hetimi rezulton se subjekti i rivlerësimit, së bashku me deklaratën *Vetting*, ka depozituar deklaratën<sup>55</sup> noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 26.4.2013, për shitjen e automjetit tip “Nissan”, me targë \*\*\*, për skrap, në vlerën 50.000 lekë. Në këtë deklaratë, subjekti ka deklaruar: “*Automjeti me targë \*\*\* nuk është në gjendje pune, pasi është amortizuar plotësisht. Në këto kushte, unë kam rënë në marrëveshje me z. O.K (i cili ka nënshkruar gjithashtu deklaratën noteriale) që ai ta marrë mjetin tim dhe ta shesë për skrap kundrejt vlerës 50.000 lekë, të cilën e mora sot nga z. O.K, cash në dorë, jashtë zyrës së notarisë*”.

**21.6.2.iv** Për sa më sipër, Komisioni duket se nuk konstatoi problematika lidhur me ligjshmërinë e këtyre të ardhurave. Rezultoi se të ardhurat janë në një shumë më të lartë sesa vlera e automjetit, çka e mbulon investimin.

**21.7** Komisioni kreu gjithashtu analizën financiare për gjithë vitin 2016, e cila rezultoi pozitive.

<sup>54</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.7.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>55</sup> Aneks nr. 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së.

**22. Llogari pranë Intesa Sanpaolo Bank**, me gjendje në datën 30.12.2016 në vlerën 4.000 euro. Burimi i krijimit: Të ardhura nga ekzekutim vendimi gjyqësor nr. \*\*\*, datë 4.4.2015, në vlerën 1.266.120 lekë dhe kursimet nga pagat. Pjesa e tij takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës<sup>56</sup> vërtetimin e datës 30.12.2016 të Intesa Sanpaolo Bank, për gjendjen e llogarisë nr. \*\*\* të Spartak Mitrushit, në shumën 4.000 euro.

**22.1** ILDKPKI-ja në raportin e tij është shprehur: *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga Intesa Sanpaolo Bank.*

**22.2** Intesa Sanpaolo Bank<sup>57</sup> informon se shtetasi Spartak Mitrushi ka pasur llogari pranë kësaj banke. Nga verifikimi i *statement*-it rezulton se gjendja në llogari në datën 27.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, është në vlerën 4.000 euro.

**22.3** Komisioni konstatoi se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga Intesa Sanpaolo Bank.

**23. Biçikletë, blerë në shtator 2015** (blerë në treg të lirë, nuk disponon dokument/faturë blerjeje). Vlera: 25.000 lekë. Burim i krijimit: Të ardhura nga paga. Pjesa takuese: 100%.

Komisioni, shpenzimin e kryer për blerjen e biçikletës e ka përfshirë në analizën financiare të vitit 2015, sipas deklaratimit të subjektit dhe nuk i kanë rezultuar problematika.

### **Detyrime financiare**

**24.** Kredi për blerje apartament banimi me sipërfaqe 107 m<sup>2</sup>, marrë në Societe Generale Albania (ish-Banka Popullore) sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 6.10.2006, në shumën 35.000 euro dhe shtojcën e kontratës me nr. \*\*\*, datë 18.6.2007, me afat 15 vjet. Shlyerja fillon në datën 6.11.2006 dhe përfundon më 8.2.2022, me interes Libor euro 12 milionë, plus 4% në vit dhe me këst mujor aktual 259.50 euro (kësti është i ndryshueshëm çdo vit, në varësi të Libor Eur). Gjendja e detyrimit: 13.988,23 euro. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente<sup>58</sup>.

**24.1** ILDKPKI-ja në raportin e tij është shprehur: *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga Societe Generale Albania.*

**24.2** Këtë kredi, qëllimin, kohën e disbursimit dhe përdorimin e saj Komisioni e ka trajtuar si një nga burimet e krijimit për blerjen e apartamentit.

**24.3** OTP Bank<sup>59</sup> (ish-Societe Generale Albania) informon se vlera e mbetur pa shlyer në datën 27.1.2017 është 13.988,23 euro.

**24.4** Për sa rezultoi më sipër, Komisioni konstatoi se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga OTP Bank.

---

<sup>56</sup> Aneks nr. 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>57</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.7.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>58</sup> Konfirmim i bankës Societe Generale Albania nr. \*\*\* prot., datë 17.1.2017, ku konfirmohet kredia e marrë nr.\*\*\*, e datës 6.10.2006, në shumën 35.000 euro nga K.M, me gjendje detyrimi 13.988,23 euro. Kontratë huaje afatgjatë, nr. \*\*\*, datë 6.10.2006, me nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 6.10.2006 për shumën 35.000 euro, me palë kredidhënës Banka Popullore sh.a dhe kredimarrës shtetasit K.P e Spartak Mitrushi, për blerje apartamenti. Shtojcë e kontratës hua afatgjatë nr. \*\*\*, datë 6.10.2007, për ndryshimin e afatit të kredisë nga 120 muaj në 180 muaj, si dhe plan-amortizimit të kësaj kredie me nr. \*\*\*, e datës 26.1.2017 (aneks nr. 4/8 në dosjen e ILDKPKI-së).

<sup>59</sup> Me shkresën nr. prot.\*\*\*, datë 3.8.2021.

**25. Kredi për blerje toke me sipërfaqe 1.250 m<sup>2</sup>**, marrë në bankën Societe Generale Albania, sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 21.12.2010, në shumën 33.000 euro, me afat 15 vjet. Shlyerja fillon më 6.1.2011 dhe përfundon më 8.1.2026, me interes Libor Eur 12 milionë, plus 4% në vit dhe jo më pak se 5%, me këst mujor aktual 260,93 euro (kësti është i ndryshueshëm çdo vit, në varësi të Libor Eur). Gjendja e detyrimit: 22.918,24 euro. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën disa dokumente<sup>60</sup>.

**25.1** ILDKPKI-ja në raportin e tij është shprehur: *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga Societe Generale Albania, ZVRPP Tiranë dhe DPPPP.*

**25.2** Këtë kredi Komisioni e ka trajtuar më sipër në këto rezultate si një nga burimet e krijimit për blerjen e tokës arë.

**25.3** Lidhur me vlerën e mbetur pa shlyer, OTP Bank<sup>61</sup> (ish-Societe Generale Albania) informon se vlera e mbetur në datën 27.1.2017 është 22.918,24 euro.

#### **Burimet e krijimit për blerjen e apartamentit**

**25.4** Lidhur me vlerën e mbetur pa shlyer, OTP Bank<sup>62</sup> (ish-Societe Generale Albania) informon se vlera e mbetur në datën 27.1.2017 është 13.988,23 euro.

**25.5** Për sa rezultoi më sipër, Komisioni konstatoi se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga OTP Bank.

#### **Deklarimi i pasurive të bashkëshortes së subjektit, znj. K.M**

**26. Apartament banimi me sipërfaqe 107 m<sup>2</sup>** (93 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi + 14 m<sup>2</sup> ambient i përbashkët), rruga “\*\*\*\*”, blerë me kontratë sipërmarrjeje datë 12.9.2006 (i pahipotekuar), me vlerë 75.000 euro. Burimi i krijimit: Kredi në Societe Generale Bank (ish-Banka Popullore) në shumën 35.000 euro, sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 6.10.2006, nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”, në emër të bashkëshortit sipas kontratës noteriale datë 26.3.2008, në vlerë 1.500.000 lekë dhe kursime të familjes. Pjesa takuese: 50%.

**27. Tokë arë me sipërfaqe 1.250 m<sup>2</sup>**, ndodhur në P., Tiranë, blerë me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.11.2010, me vlerë 312.500 lekë. Burimi i krijimit: Kredi nga banka Societe Generale Albania në shumën 33.000 euro, sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 21.12.2010. Pjesa takuese: 50%.

**27.1** Këto pasuri janë trajtuar nga Komisioni dhe për to është konkluduar më sipër në këtë vendimmarrje, te deklarimi i pasurisë nga subjekti i rivlerësimit.

---

<sup>60</sup> Kontratë kredie afatgjatë nr. \*\*\*, dhjetor 2010, me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.12.2010, për shumën 33.000 euro, me palë kredidhënëse banka Societe Generale dhe kredimarrës shtetasit K.M dhe garantor Spartak Mitrushit, për blerje toke, si dhe plan-amortizimit të kësaj kredie me nr. \*\*\*, datë 26.1.2017 (aneks nr. 4/9).

Konfirmim i Societe Generale Albania nr. 0004 prot., datë 17.1.2017, ku konfirmohet kredia e marrë nr. \*\*\*, e datës 21.12.2010, në shumën 33.000 euro, nga shtetasja K.M, me gjendje detyrimi 22.918,24 euro (aneks nr. 4/8).

<sup>61</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.8.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>62</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.8.2021.

**28. Aksione në Societe Generale Bank** 40 copë, me vlerë 1.941,39 euro, sipas çmimit të tregtuar në bursë. Çmimi i tregtimit më 26.1.2017 ka qenë 48.535 euro/aksion. Burim krijimi: Dhuruar nga banka si pjesë e skemës së dhurimit të aksioneve për stafin e bankës. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente<sup>63</sup>.

**28.1** Nga korrespondenca e Komisionit me OTP Bank (ish-Societe Generale Albania), kjo e fundit nuk e konfirmon zotërimin e këtyre aksioneve nga bashkëshortja e subjektit.

**28.2** Banka Societe Generale<sup>64</sup> me *email*-in e datës 13.11.2017 konfirmon se *shtetasja K.M me shkëputjen e marrëdhënieve me bankën në korrik 2014 nuk i ka përfituar 40 aksionet dhuruar nga grupi në nëntor 2010.*

**28.3** Komisioni i ka kërkuar<sup>65</sup> subjektit sqarime lidhur me këtë fakt, i cili në përgjigje ka deklaruar: *“Në lidhje me këtë pyetje, ju sqarojmë se sipas shkresës së dërguar nga Banka Societe Generale, Francë, datë 20.12.2010, bashkëshortja ime K.M është njoftuar që i është alokuar e drejta për aksione në Societe Generale, Francë (bashkëngjitur shkresa e cituar). Sqaroj se këto janë aksione në Bankën Societe Generale Francë dhe jo në ish-Bankën Societe Generale Albania, që më pas u ble nga Banka OTP. Sipas dokumentit “Account statement, share rights” që i është dërguar bashkëshortes time në datën 2.2.2018, konfirmohet që ajo zotëron 40 aksione, vlera e të cilave është e luhatshme në periudha të ndryshme në varësi të vlerës së një aksioni në bursë, siç mund të vërehet dhe në dokumentin bashkëngjitur, që tregon pozicionin në datën 14.10.2016. Zotërimi i këtyre aksioneve konfirmohet edhe nga pagesa e dividendit që Banka Societe Generale Francë arkëton një herë në vit në llogarinë e bashkëshortes sime në vlera imateriale 30 – 50 euro/vit në varësi të fitimit që shpërndahet. Bashkëngjitur po ju dërgoj dhe kalimin në llogarinë e saj të dividendit për vitet 2023 dhe 2024 si provë e ekzistencës aktuale të këtyre aksioneve. Nuk di të shpjegoj pse OTP Bank ka dhënë këtë informacion pranë Komisionit, por sjell në vëmendje të Komisionit që edhe në informacionin e paraqitur nga kjo bankë për kreditë e marra nga ana ime para blerjes së ish-Bankës Societe Generale Albania, nuk ka qenë korrekt, siç e konfirmuan dhe me vërtetimin e paraqitur në pyetësorin e parë. Unë konfirmoj që këto aksione janë alokuar nga banka Societe Generale Francë dhe bashkëshortja ime është njoftuar nëpërmjet postës me këtë informacion dhe nuk ka aplikuar ndonjëherë për përfitimin e këtyre aksioneve”.*

**28.4** Në analizë të dokumentacionit të depozituar, Komisioni konstatoi se në datën e dorëzimit të deklaratës *Vetting* nga subjekti i rivlerësimit, bashkëshortja e tij ka zotëruar 40 aksione të dhuruara nga banka Societe Generale në vlerën 1.941,39 euro. Mbi këtë konstatim, Komisioni konkludon se bashkëshortja e subjektit ka deklaruar me vërtetësi e saktësi vlerën e aksioneve.

**29. Llogari në euro pranë Intesa Sanpaolo Bank** nr. \*\*\*, me gjendje më 17.1.2017 në shumën 5.596,20 euro. Burimi i krijimit: të ardhura nga shitja e automjetit në vlerën 7.000 euro, sipas kontratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.7.2016. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka

---

<sup>63</sup> “Consult my Portfolio” e Societe Generale (në gjuhën angleze) e datës 25.1.2017 me gjendje 1.941 euro me çmim të tregtuar (datë 26/1/2017 – 11:30:00) 48.535 euro; dokument i Societe Generale Bank (Paris) në gjuhën franceze, i datë 31.3.2015; dokument i Societe Generale (në gjuhën angleze) datë 20.12.2010 dhe datë 3.1.2011 (aneks nr. 4/10 në dosjen e ILDKPKI-së).

<sup>64</sup> Aneks nr. 22 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>65</sup> Me pyetësorin nr. 3, datë 9.10.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

bashkëlidhur deklaratës<sup>66</sup> vërtetimin e datës 17.1.2017 të Intesa Sanpaolo Bank për balancën e llogarisë të shtetasës K.M, me gjendje në shumën 5.596,20 euro.

**29.1** ILDKPKI-ja në raportin e tij është shprehur: *Ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka ka ndodhur për shkak të paraqitjes së tyre në dy data të ndryshme dhe, konkretisht, deklarimi i përket datës 17.1.2017, ndërsa kërkesa dhe konfirmimi i bankës i përket datës 27.1.2017.*

**29.2** Intesa Sanpaolo Bank<sup>67</sup> informon se shtetasja K.M është kliente e kësaj banke. Nga verifikimi i *statement*-it rezulton se gjendja në llogari në datën 27.1.2017 kur është depozituar deklarata *Vetting* është në vlerën 3.598,13 euro.

**29.3** Komisioni konstatoi se ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka ka ndodhur për shkak të paraqitjes së tyre në dy data të ndryshme dhe, konkretisht, dokumentacioni i depozituar nga subjekti i përket datës 17.1.2017, ndërsa deklarata *Vetting* është depozituar në datën 27.1.2017, ndaj në këto kushte nuk vëren ndonjë problematikë që ndikon në rivlerësimin e subjektit.

**29.3** Lidhur me burimin e krijimit të kësaj llogarie, subjekti ka deklaruar të ardhurat nga shitja e automjetit.

**29.4** Nga verifikimi i llogarisë, rezulton se shtetasja K.M ka depozituar në llogarinë e saj, në datën 15.7.2016, shumën 4.000 euro, me përshkrimin “Nga shitja e makinës”.

**29.5** Nga korrespondenca e Komisionit me DPSHTRR-në, kjo e fundit ka vendosur në dispozicion<sup>68</sup> kontratë shitblerjeje automjeti nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.7.2016, me palë shitëse K.F.M dhe palë blerëse shoqërinë “M.A” sh.p.k. për automjetin tip “Daimler Chrysler”, me targë \*\*\*, në vlerën 7.000 euro. Në këtë kontratë cilësohet se pala blerëse mori sendin në dorëzim dhe me vullnet të lirë i ka paguar palës shitëse shumën *cash* në dorë.

**29.6** Nga verifikimi i dokumentacionit, Komisioni konstatoi se subjekti ka deklaruar me vërtetësi e saktësi burimin e krijimit të llogarisë objekt hetimi.

**30. Llogari pranë Intesa Sanpaolo Bank** nr. \*\*\*, me gjendje më 17.1.2017 në shumën 41.096,33 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhura nga pagat mujore. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës<sup>69</sup> vërtetimin e datës 17.1.2017 të Intesa Sanpaolo Bank, për balancën e llogarisë të shtetasës K.M, me gjendje në shumën 41.096,33 lekë.

**30.1** ILDKPKI-ja në raportin e tij është shprehur: *Ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka ka ndodhur për shkak të paraqitjes së tyre në dy data të ndryshme dhe konkretisht, deklarimi i përket datës 17.1.2017, ndërsa kërkesa dhe konfirmimi i bankës i përket datës 27.1.2017.*

---

<sup>66</sup> Aneks nr. 4/11 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>67</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.7.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>68</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.7.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>69</sup> Aneks nr. 4/11 në dosjen e ILDKPKI-së.

**30.2** Intesa Sanpaolo Bank<sup>70</sup> informon se shtetasja K.M është kliente e kësaj banke. Nga verifikimi i *statement*-it rezulton se gjendja në llogari në datën 27.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, është në vlerën 110.773,33 lekë.

**30.3** Komisioni konstaton se ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka ka ndodhur për shkak të paraqitjes së tyre në dy data të ndryshme dhe, konkretisht, dokumentacioni i depozituar nga subjekti i përket datës 17.1.2017, ndërsa deklarata *Vetting* është depozituar në datën 27.1.2017, ndaj në këto kushte nuk vëren ndonjë problematikë që ndikon në rivlerësimin e subjektit.

**31. Llogari pranë Intesa Sanpaolo Bank** nr. \*\*\*, me gjendje më 17.1.2017 në shumën 157.147,06 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhura nga pagat mujore, paga e 13 dhe shpërblime. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës<sup>71</sup> vërtetimin e datës 17.1.2017 të Intesa Sanpaolo Bank, për balancën e llogarisë të shtetasës K.M, me gjendje në shumën 157.147,06 lekë.

**31.1** ILDKPKI-ja në raportin e tij është shprehur: *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga Intesa Sanpaolo Bank.*

**31.2** Intesa Sanpaolo Bank<sup>72</sup> informon se shtetasja K.M është kliente e kësaj banke.

**31.3** Nga verifikimi i *statement*-it rezulton se gjendja në llogarinë rrjedhëse në datën 27.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, është në vlerën 157.147,06 lekë.

**31.4** Për sa më sipër rezultoi, Komisioni konstaton se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga Intesa Sanpaolo Bank.

**32. Llogari pranë Intesa Sanpaolo Bank** nr. \*\*\*, me gjendje më 17.1.2017 në shumën 119.390,59 lekë. Burimi i krijimit: 50% nga pagat mujore dhe 50% nga skema e kursimit që ofron Intesa Sanpaolo Bank për stafin. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës<sup>73</sup> vërtetimin e datës 17.1.2017 të Intesa Sanpaolo Bank, për balancën e llogarisë të shtetasës K.M, me gjendje në shumën 119.390,59 lekë.

**32.1** ILDKPKI-ja në raportin e tij është shprehur: *Ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka ka ndodhur për shkak të paraqitjes së tyre në dy data të ndryshme dhe, konkretisht, deklarimi i përket datës 17.1.2017, ndërsa kërkesa dhe konfirmimi i bankës i përket datës 27.1.2017.*

**32.2** Intesa Sanpaolo Bank<sup>74</sup> informon se shtetasja K.M është kliente e kësaj banke.

**32.3** Nga verifikimi i *statement*-it rezulton se gjendja në llogarinë rrjedhëse në datën 27.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, është në vlerën 122.043,26 lekë.

**32.4** Komisioni konstaton se ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka ka ndodhur për shkak të paraqitjes së tyre në dy data të ndryshme dhe, konkretisht, dokumentacioni i depozituar nga subjekti i përket datës 17.1.2017, ndërsa deklarata *Vetting* është

<sup>70</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.7.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>71</sup> Aneks nr. 4/11 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>72</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.7.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>73</sup> Aneks nr. 4/11 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>74</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.7.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

depozituar në datën 27.1.2017, e për pasojë, nuk vëren ndonjë problematikë që ndikon në rivlerësimin e subjektit.

**33. Llogari pranë Intesa Sanpaolo Bank nr. \*\*\***, me gjendje më 17.1.2017 në shumën 60.274,91 lekë. Burimi i krijimit: Kursime nga pagat mujore të shtetas K.M 100%.

**33.1** Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës<sup>75</sup> vërtetimin e datës 17.1.2017 nga Intesa Sanpaolo Bank, për balancën e llogarisë së shtetas K.M, me gjendje në shumën 60.274,91 lekë.

**33.2** ILDKPKI-ja në raportin e tij është shprehur: *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga Intesa Sanpaolo Bank.*

**33.3** Intesa Sanpaolo Bank<sup>76</sup> informon se shtetasja K.M ka pasur llogari pranë kësaj banke. Nga verifikimi i *statement*-it rezulton se gjendja në llogari në datën 27.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, është në vlerën 60.274,91 lekë.

**33.4** Për sa më sipër rezultoi, Komisioni konstaton se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga Intesa Sanpaolo Bank.

### **Detyrime financiare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. K.M**

**34.** Kredi për blerje apartament banimi me sipërfaqe 107 m<sup>2</sup>, marrë në bankën Societe Generale (ish-Banka Popullore), sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 6.10.2006, në shumën 35.000 euro dhe shtojcën e kontratës nr. \*\*\*, datë 18.6.2007, me afat 15 vjet. Shlyerja fillon më 6.11.2006 dhe përfundon më 8.2.2022, me interes Libor Eur 12 milionë, plus 4% në vit dhe me këst mujor aktual 259,50 euro (kësti është i ndryshueshëm çdo vit në varësi të Libor Eur). Gjendja e detyrimit: 13.988,23 euro.

**35. Kredi për blerje toke me sipërfaqe 1.250 m<sup>2</sup>**, marrë në bankën Societe Generale sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 21.12.2010, në shumën 33.000 euro, me afat 15 vjet. Shlyerja fillon më 6.1.2011 dhe përfundon më 8.1.2026, me interes Libor Eur 12 milionë, plus 4% në vit dhe jo më pak se 5% dhe me këst mujor aktual 260,93 euro (kësti është i ndryshueshëm çdo vit në varësi të Libor Eur). Gjendja e detyrimit: 22.918,24 euro.

**35.1** Këto kredi janë trajtuar nga Komisioni dhe për to është konkluduar më sipër në këtë vendimmarrje, te deklarimi i detyrimeve nga subjekti i rivlerësimit.

### **Konkluzion përfundimtar i vlerësimit të pasurisë**

**36.** Në lidhje me problematikën e konstatuar në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues, duke konstatuar se me pasuritë e krijuara shumë kohë para fillimit të detyrës së subjektit të rivlerësimit, për të cilat subjekti i është kërkuar të provojë të ardhurat nga punësimi thuajse para 20 viteve, për të cilat nuk ngrihen dyshime lidhur me krijimin e këtyre të ardhurave nga aktivitete të kundërligjshme, çmon se këto të ardhura, pavarësisht se nuk kënaqin përcaktimin e nenit D/3 të Aneksit të Kushtetutës, duhet të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë. Trupi gjykues mban në konsideratë edhe faktin se përgjatë hetimit subjekti nuk ka ndryshuar

<sup>75</sup> Aneks nr. 4/11 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>76</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.7.2021, administruar në dosjen e Komisionit.



deklarimet dhe, në mungesë të ndonjë treguesi/indicieje, që do krijonin dyshime se subjekti i vlerësimit me deklarin e të ardhurave të tillë ka synuar të mashtrtojë organet e rivlerësimit ose ka deklaruar qëllimisht ndryshe në mënyrë të rremë, duke vlerësuar se kjo situatë faktike nuk çmohet se është e drejtë të konsiderohet si një mangësi apo defekt, i cili të prodhojë për subjektin e rivlerësimit vendosjen e masës së shkarkimit nga detyra.

**37.** Për këto arsye, trupi gjykues, në vlerësim të situatës faktike, si dhe në përputhje edhe me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, vendimi nr. 6/2022, çmon se problematikat e konstatuara nuk janë të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë sipas përcaktimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dhe se ato nuk konsiderohen se mund të mjaftojnë si shkaqe objektive e proporcionale të vendosura në procesin e rivlerësimit kalimtar për të ngarkuar drejtpërdrejt me masë disiplinore subjektin e rivlerësimit.

**38.** Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Spartak Mitrushi, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**39.** Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2017, me konstatimin për përshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës të subjektit Spartak Mitrushi, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. \*\*\* prot., datë 9.4.2024.

### **Hetimi i Komisionit**

**39.1** Komisioni, në vijim, si organi i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

**39.2** Më tej, pas kërkesës së Komisionit<sup>77</sup> për përditësimin e informacioneve, AKSIK-ja<sup>78/79</sup> nuk ka konfirmuar të dhëna të përditësuara për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme.

**39.3** Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Spartak Mitrushi, arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka

<sup>77</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.4.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>78</sup> Me shkresën e datës 8.5.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>79</sup> Me shkresën e datës 8.5.2024.

dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka kryer deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**40.** Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale<sup>80</sup> është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**40.1** Raporti është kontrolluar në drejtim të saktësisë dhe të standardizimit të tij nga anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ky raport i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: (a) aftësive profesionale; (b) aftësive organizative; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

**40.2** Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (a) formularit të vetëdeklarimit, të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; (b) 5 dokumenteve ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (c) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

### **41. Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit**

#### *a) Saktësia e formularit të vetëdeklarimit*

Formulari është plotësuar sipas formës standarde, në mënyrë të plotë, me faqe të nënshkruara rregullisht, pa mangësi nga pikëpamja formale.

#### *b) Përvoja profesionale në 10 vitet e fundit*

Sipas të dhënave të deklaruara në rubrikën B të formularit (të dhëna për punësimin), subjekti i rivlerësimit, z. Spartak Mitrusi, ka deklaruar se: (i) për periudhën mars 2006 – gusht 2009 ka punuar si jurist në shoqërinë “A.C” sh.p.k.; (ii) për periudhën gusht 2009 – mars 2010 ka punuar specialist në Shërbimin e Provës në Zyrën Vendore F, (iii) për periudhën mars 2010 – dhjetor 2013 ka punuar drejtor i Shërbimit të Provës në Zyrën Vendore F, (iv) në periudhën dhjetor 2013 – qershor 2015 ka qenë pa punë; (v) ndërkohë, në periudhën qershor 2015 e në vazhdim, pra edhe aktualisht, subjekti Spartak Mitrusi ushtron funksionin e ndihmësit ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit.

#### *c) Detyrat e kryera 3 vitet e fundit dhe të dhënat statistikore*

Subjekti i rivlerësimit, z. Spartak Mitrusi, lidhur me tri vitet e fundit të punës në formularin e vetëdeklarimit ka sqaruar si vijon: E drejta penale; E drejta administrative.

---

<sup>80</sup> Raporti i KLGJ-së me nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2023, administruar nga Komisioni.

Referuar të dhënave të formularit të vetëdeklarimit, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Spartak Mitrushi, si ndihmës ligjor ka më pak se tri vite punë. Konkretisht, për periudhën objekt i rivlerësimit kalimtar, ai ka një periudhë pune prej 1 viti e 4 muajsh (qershor 2015 – gusht 10.2016). Në periudhën 8.10.2013 – qershor 2015, subjekti Spartak Mitrushi ka qenë i papunësuar.

ç) *Në lidhje me fushën e specializimeve*, subjekti Spartak Mitrushi në formularin e vetëdeklarimit ka deklaruar si vijon:

- Master Profesional me temë “Administrimi i Institucioneve Penale në Sistemin e Drejtësisë Penale”, përfunduar pranë Universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës.

- Master Profesional në të Drejtën Penale, ndjekur studimet pranë Fakultetit të Drejtësisë në universitetin “J”.

d) *Lidhur me numrin e çështjeve të caktuara, të përfunduara dhe të mbartura*, z. Spartak Mitrushi ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit si më poshtë:

i. Numri i çështjeve të caktuara tri vitet e fundit të ushtrimit të detyrës: 1236.

ii. Numri i çështjeve të përfunduara tri vitet e fundit të ushtrimit të detyrës: 485.

iii. Numri i çështjeve të mbartura vitin e fundit të ushtrimit të detyrës: 791.

dh) *Trajnimet në 3 vitet e fundit*

Subjekti i rivlerësimit, z. Spartak Mitrushi, në formularin e vetëdeklarimit ka deklaruar se ka kryer 4 trajnime<sup>81</sup> në Shkollën e Magjistraturës në tri vitet e fundit të ushtrimit të detyrës, si dhe të tjera trajnime jashtë programit<sup>82</sup> të Shkollës së Magjistraturës dhe, po ashtu, ka depozituar edhe dokumentacionin provues.

---

<sup>81</sup> (i) Trajnim me temë “Jurisprudenca e GJEDNJ-së lidhur me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Konventa e OKB-së dhe legjislacioni shqiptar lidhur me PAK-un dhe roli i sistemit të drejtësisë”, trajnim i kryer në datën 3.11.2016; (ii) Trajnim me temë “Zhvillimet e legjislacionit të prokurimeve publike dhe atij fiskal në këndvështrimin e gjyqimit administrativ”, trajnim i zhvilluar në datën 28.10.2015; (iii) Trajnim me temë “Tatimi mbi vlerën e shtuar, tatimi mbi të ardhurat dhe taksimi ndërkombëtar në ndihmë të gjykimeve administrative”, trajnim i zhvilluar në datat 5 dhe 6 tetor 2016; (iv) Trajnim me temë “Zbatimi i drejtësisë administrative në Shqipëri, rastet procedurale”, trajnim i zhvilluar në datën 4.11.2015.

<sup>82</sup> (i) Trajnim me temë “Administration of Social Institutions in the Justice System”, i kryer në datën 21.11.2014, i organizuar nga OSCE dhe Universiteti i Tiranës; (ii) Trajnim me temë “Sistemi i vlerësimit të rrezikshmërisë së të dënuarit”, trajnim i kryer në datën 3 – 4 dhjetor 2013, i organizuar nga OSCE dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës; (iii) Trajnim me temë “Menaxhimi dhe Drejtimi Strategjik”, i kryer në vitin 2012, i organizuar nga Projekti i Binjakëzimit i Ministrisë së Drejtësisë së Mbretërisë së Bashkuar, përfaqësuar nga Këshilltari Rezident Alan McDonald dhe Ministrisë së Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës; (iv) Trajnim me temë “Politikat e rekrutimit të punonjësve”, i kryer në vitin 2012, i organizuar nga Projekti i B i Ministrisë së Drejtësisë së Mbretërisë së Bashkuar, përfaqësuar nga Këshilltari Rezident A.M dhe Ministrisë së Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës; (v) Trajnim me temë “Mbikëqyrja dhe vlerësimi i punonjësve”, i kryer në vitin 2012, i organizuar nga Projekti i B i Ministrisë së Drejtësisë së Mbretërisë së Bashkuar, përfaqësuar nga Këshilltari Rezident A.M dhe Ministrisë së Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës; (vi) Trajnim me temë “Sistemi i vlerësimit të rrezikut”, i kryer në vitin 2012, i organizuar nga Projekti i B i Ministrisë së Drejtësisë së Mbretërisë së Bashkuar, përfaqësuar nga Këshilltari Rezident A.M dhe Ministrisë së Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës; (vii) Trajnim me temë “Mbledhja dhe Menaxhimi i Informacionit”, i kryer në vitin 2012, i organizuar nga Projekti i B i Ministrisë së Drejtësisë së Mbretërisë së Bashkuar, përfaqësuar nga Këshilltari Rezident A.M dhe Ministrisë së Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës; (viii) Trajnim me temë “Drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi viktimë-kundërvajtës”, i kryer në tetor të vitit 2012, i organizuar nga UNICEF dhe FZK; (ix) Trajnim me temë “Zhvillimi i aftësive menaxhuese”, i kryer në datat 17 dhe 18 shkurt të vitit 2011, i organizuar nga OSBE dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës; (x) Trajnim me temë “Drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi viktimë-kundërvajtës”, i kryer në prill të vitit 2010, i organizuar nga UNICEF dhe FZK; (xi) Trajnim me temë “Shërbimi i Provës në Shqipëri”, i kryer në datat 22 – 26 shtator të vitit 2009, i organizuar nga OSCE dhe EURALIUS.

## **Të dhëna nga burime arkivore të KLGJ-së**

**42.** Për subjektin e rivlerësimit, z. Spartak Mitrush, nuk ka të dhëna në burimet arkivore të KLGJ-së për periudhën e rivlerësimit, për shkak se ndihmësit ligjorë ishin njësi e brendshme, e organizuar dhe vareshin nga gjykatat administrative. Për rrjedhojë, të dhënat profesionale dhe etike të tyre i disponojnë gjykatat përkatëse, ku ata kanë ushtruar detyrën si ndihmës ligjorë.

### **Analiza e gjetjeve**

**43.** Analiza e gjetjeve u referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dokumenteve ligjore të vëzhguara të përzgjedhura me short.

#### **43.1 Aftësitë profesionale**

##### *a) Njohuritë ligjore*

Procesi i rivlerësimit kalimtar të ndihmësve ligjorë pranë gjykatave administrative parashikohet dhe rregullohet nga neni 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016<sup>83</sup>, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nga neni 165 i ligjit nr. 96/2016<sup>84</sup>, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Referuar parashikimeve ligjore e nënligjore në fuqi për kohën kur kryhet ky proces vlerësimi profesional për ndihmësit ligjorë, ndryshe nga magjistratët-gjyqtarë, nuk ka pasur të miratuar nga një organ kompetent një sistem vlerësimi profesional.

Për rrjedhojë, për ndihmësit ligjorë në gjykatat administrative nuk ka kriteret matëse të punës, sikurse ato kanë ekzistuar për magjistratët-gjyqtarë, prandaj vlerësimi i aftësive profesionale të tyre nuk ndjek detyrimisht të njëjtat rregulla sikurse për magjistratët-gjyqtarë.

Në këto kushte, vlerësimi i aftësive profesionale të ndihmësve ligjorë pranë gjykatave administrative do të kryhet në përputhje me parashikimin e nenit 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 të sipërcituar, si dhe bazuar në përmbajtjen e nenit 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar më vonë.

- Z. Spartak Mitrush ka filluar punë si ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, pas emërimit të tij me urdhrin nr. \*\*\*, datë 9.6.2015, të kryetarit të asaj gjykate, z. K.S.

- Për periudhën objekt i rivlerësimit kalimtar (8.10.2013 – 8.10.2016), subjekti Spartak Mitrush ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor për 1 vit e 4 muaj (9.6.2015 – 8.10.2016). Referuar parashikimit të nenit 41, pika 3 e ligjit nr. 84/2016: “Në rast se subjekti i rivlerësimit ka më pak se tri vite në detyrë, periudha e vlerësimit konsiderohet e gjithë koha gjatë ushtrimit të detyrës”.

---

<sup>83</sup> Ligji nr. 84/2016, neni 42, pika 2: “Këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, Gjykatës Administrative, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në: a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; dhe b) rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës”.

<sup>84</sup> Ligji nr. 96/2016, neni 165, pika 1: “Këshilltari i gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësi ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe në gjykatat administrative, si dhe inspektori në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që nuk gëzojnë statusin e gjyqtarit ose prokurorit, janë subjekt i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Vlerësimi i aftësive profesionale të ndihmësve ligjorë në gjykatat administrative, përfshirë këtu subjektin e rivlerësimit, z. Spartak Mitrushi, të mbështetet edhe në parashikimin ligjor të sipërcituar, pra në nenin 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative”.

### **43.2 Aftësitë organizative**

#### *a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*

Subjekti i rivlerësimit, z. Spartak Mitrushi, rezulton se ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, nga data e emërimit të tij, 9.6.2015, e në vazhdim.

Në funksionin e ndihmësit ligjor pranë kësaj gjykate, ai ka deklaruar se në periudhën 9.6.2015 – 8.10.2016 ka përpiluar 485 relacione. Ndihmësi ligjor nuk ka çështje të mbartura, pasi ai shqyrton aq çështje sa nxjerr gjyqtari për gjykim. Këto të dhëna statistikore janë pasqyruar nga vetë subjekti në formularin e vetëvlerësimit profesional.

Ndërsa, sipas informacionit zyrtar të paraqitur nga Gjykata Administrative e Apelit, për efekt të organizmit të përzgjedhjes së 5 çështjeve me short, rezulton se për periudhën 9.6.2015 – 8.10.2016 subjekti i rivlerësimit ka asistuar gjyqtaren L.S në përgatitjen, përpunimin e 615 çështjeve (relacioneve apo projektvendimeve).

Për subjektin e rivlerësimit nuk ka të dhëna direkte për ngarkesën dhe punën e tij, por të dhënat janë nxjerrë nga dosjet gjyqësore të gjyqtarit, pranë të cilit ai është caktuar të asistojë.

Kuadri ligjor në fuqi për kohën kur kryhet ky vlerësim profesional, nuk përcakton standarde minimale pune për ndihmësin ligjor të Gjykatës Administrative të Apelit. Puna e ndihmësit ligjor është e lidhur drejtpërdrejt me veprimtarinë e gjyqtarit që ai asiston, pra ndihmësi kryen ato detyra që i caktohen nga vetë gjyqtari.

Nga të dhënat statistikore të deklaruara nga vetë ndihmësi ligjor Spartak Mitrushi, por edhe ato të dhëna të përcjella nga Gjykata Administrative e Apelit për efekt të shortit, duket se subjekti i rivlerësimit ka përfunduar në kohë detyrat e ngarkuara nga gjyqtari të cilit i ka asistuar.

#### *b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore*

Detyrat e ndihmësit ligjor të gjykatave administrative janë parashikuar në nenin 6 të ligjit nr. 49/2012 dhe konkretisht në paragrafët 1 e 2 të tij, ku sanksionohet se:

*1. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe i Gjykatës së Apelit Administrativ në veprimtarinë e tij ndihmohet nga ndihmësi ligjor.*

*2. Ndihmësi ligjor ndihmon dhe këshillon gjyqtarin lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor, si dhe përgatit projektakte procedurale të nevojshme për gjykimin. Me kërkesë të gjyqtarit, ndihmësi ligjor bën kërkime ligjore dhe përgatit opinione me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material që lidhen me çështjet në gjykim.*

Rezulton qartë nga përmbajtja e ligjit të sipërcituar se ndihmësi ligjor nuk kryen procedura gjyqësore. Ky kriter vlerësimi shërben dhe zbatohet vetëm për gjyqtarin, i cili ka të përcaktuara

qartësisht në ligj detyrat e tij procedurale, duke filluar që nga data e marrjes me short të çështjes e deri në datën e përfundimit të saj me vendim përfundimtar.

*c) Aftësia për të administruar dosjet*

Edhe ky kriter vlerësimi zbatohet vetëm për gjyqtarët. As në ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative” dhe në asnjë ligj apo akt nënligjor tjetër nuk parashikohet si detyrë për ndihmësin që të administrojë një dosje gjyqësore.

### **43.3 Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

*a) Etika në punë*

Nga të dhënat e dërguara nga Gjykata Administrative e Apelit me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 20.1.2023, nuk rezultojnë të dhëna negative për etikën në punë të subjektit Spartak Mitrushi për periudhën gjatë së cilës ai ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor pranë kësaj Gjykate (9.6.2015 – 8.10.2016). Gjithashtu, nga përmbajtja e shkresës së sipërcituar rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë objekt i ndonjë procedimi disiplinor për shkelje disipline.

*b) Integriteti*

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Spartak Mitrushi, nga të dhënat e dërguara nga Gjykata Administrative e Apelit, por edhe nga dokumentet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna negative në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

*c) Paanësia*

Ky element vlerësues është tipik për gjyqtarin, i cili ka detyrimin ligjor jo vetëm të jetë i paanshëm në një proces gjyqësor, por edhe të sillet si i tillë sipas parimit “Drejtësia jo vetëm duhet të jepet, por edhe duhet të duket se po jepet”.

Ndihmësi ligjor nuk ka kontakte me palët ndërgjyqëse, pasi nuk është pjesëmarrës në një proces gjyqësor dhe as subjekt procedural. Ndihmësi ligjor nuk është organ vendimmarrës, por këshillues, asistues i gjyqtarit. Në tërë relacionet e përgatitura nga ndihmësi ligjor Spartak Mitrushi nuk konstatohen elemente favorizuese apo njëanshmërie në raport me palët ndërgjyqëse pjesëmarrëse në ato procese gjyqësore që u korrespondojnë atyre relacioneve.

### **43.4 Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

*a) Aftësitë e komunikimit*

Rezultoi se z. Spartak Mitrushi ka filluar punë si ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit në datën 9.6.2015, fakt i pasqyruar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.8.2021, dërguar nga kjo Gjykatë.

Me urdhër të kryetarit të asaj gjykate të datës 9.6.2015, subjekti Spartak Mitrushi është caktuar të asistojë gjyqtaren e Gjykatës Administrative të Apelit, znj. L.S.

Në të 8 dokumentet ligjore të vëzhguara nuk ka të dhëna për mënyrën e komunikimit të subjektit të rivlerësimit, z. Spartak Mitrushi, me palët ndërgjyqëse, pasi për shkak të natyrës së punës nuk

ka kontakt me ta, ndërsa gjuha e përdorur në aktet e përpiluara prej tij mund të vlerësohet si korrekte dhe normale.

Në lidhje me aftësitë e ndihmësit ligjor Spartak Mitrushi për të komunikuar me gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Apelit, me drejtuesin e Gjykatës apo edhe me pjesëtarë të stafit administrativ të asaj gjykate, nuk janë evidentuar probleme.

*b) Aftësia për të bashkëpunuar*

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 relacionet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me gjyqtarët, me kolegët e tyre dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Ndërkohë, në asnjë prej relacioneve të vëzhguara dhe praktikave përkatëse të trajtuara gjatë këtij procesi rivlerësimi, nuk është evidentuar ndonjë problematikë në bashkëveprimin e tij me gjyqtaren të cilit i ka asistuar.

*c) Gatishmëria për t'u angazhuar*

Pas një eksperience disavjeçare si jurist pranë institucioneve shtetërore (madje edhe titullar për disa kohë), subjekti i rivlerësimit në datën 9.6.2015 është emëruar ndihmës ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Subjekti Spartak Mitrushi i ka kushtuar rëndësi formimit akademik. Pas përfundimit të Fakultetit të Drejtësisë, ai ka vazhduar më tej studimet me qëllim thellimin e njohurive të tij profesionale.

Referuar formularit të vetëvlerësimit, por edhe dokumentacionit që ai ka sjellë, rezultoi se ai ka kryer disa specializime.

Ndër të tjera, tema e trajnimeve të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës dhe ku ka qenë pjesëmarrës z. Spartak Mitrushi, ka lidhje të rëndësishme me detyrën që ai ushtron si ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, pasi çështjet e trajtuara janë në kompetencë gjykimi të gjykatave administrative.

#### **44. Rivlerësimi i Komisionit për 3 dokumentet e përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit**

a. Tri dokumentet (relacionet)<sup>85</sup> e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit rezultojnë të jenë përgatitur në përputhje me parashikimet e nenit 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012<sup>86</sup>.

b. Sipas urdhrorit nr. \*\*\* , datë 9.6.2015, të kryetarit të gjykatës K.S dhe shkresës së Gjykatës Administrative të Apelit<sup>87</sup>, rezultojnë se në periudhën 9.6.2015 e në vazhdim z. Spartak Mitrushi ka asistuar, ndihmuar gjyqtaren L.S. Nga verifikimi i tre relacioneve, ashtu sikurse ka rezultuar edhe

---

<sup>85</sup> Dokumenti 1 – Relacion mbi çështjen administrative me nr. \*\*\* regjistri themeltar, datë 23.2.2015 regjistrimi, që i përket paditësit D. R. e T. të M, kundër të paditurit D. e A. T. pranë D. së P. të T. T. Dokumenti 2 – Relacion mbi çështjen administrative me nr. \*\*\* regjistri themeltar, datë 19.12.2014 regjistrimi, që i përket paditësit shoqëria “E.M”, kundër të paditurit K. i P. P. Q. S. U. “\*\*\*”, person i tretë Shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. Dokumenti 3 – Relacion mbi çështjen administrative me nr. \*\*\* regjistri themeltar, datë 3.12.2014 regjistrimi, që i përket paditësit shoqëria “\*\*\*” sh.a., kundër të paditurit D. R. T. T.

<sup>86</sup> Ligji nr. 49/2012, neni 6, pika 2: “Ndhmësi ligjor ndihmon dhe këshillon gjyqtarin lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor, si dhe përgatit projektakte procedurale të nevojshme për gjykimin. Me kërkesë të gjyqtarit, ndihmësi ligjor bën kërkime ligjore dhe përgatit opinione me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material që lidhen me çështjet në gjykim”.

<sup>87</sup> Dokumentacion i depozituar në raportin profesional të subjektit, administruar nga Komisioni.

në raportin e vlerësimit të aftësive profesionale, edhe Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit në përmbajtje të tyre, ka relatuar mosmarrëveshjet objekt gjykimi, palët ndërgjyqëse, pretendimet dhe prapësimet e tyre, ka cituar në mënyrë të sintetizuar disponimet dhe arsyetimet e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, si dhe ka listuar shkaqet e ankimit të bërë nga pala paditëse.

c. Komisioni kërkoi<sup>88</sup> nga Gjykata Administrative e Apelit tri vendimet gjyqësore të dhëna për këto çështje. Nga analiza krahasuese e 3 vendimeve të Gjykatës<sup>89</sup> dhe 3 relacioneve të konceptuara nga subjekti i rivlerësimit, rezultoi se relacionet (dokumenti 1, 2 dhe 3) janë përpiluar saktë dhe gjenden të pasqyruara njësoj në 3 vendimet gjyqësore të dhëna.

ç. Në përfundim të analizës së kryer për tri dokumentet e përzgjedhura, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

#### **45. Rivlerësimi i Komisionit për 5 dosjet e përzgjedhura me short**

i. Lidhur me 5 dokumentet (relacione)<sup>90</sup> e shortuara në mënyrë rastësore, nga verifikimi dhe krahasimi i tyre me vendimet gjyqësore të depozituara në 5 dosjet e shortuara, Komisioni konstatoi se 5 relacionet janë firmosur nga gjyqtari relator i çështjeve. Komisioni, bazuar edhe në nenin 6 të ligjit nr. 49/2012, i kërkoi Gjykatës Administrative të Apelit informacion<sup>91</sup> dhe dokumentacion (nëse ka, projektakte ligjore, relacione etj.) të konceptuar nga subjekti i rivlerësimit. Ky institucion informon<sup>92</sup> se: *“Emërimi në detyrë dhe ushtrimi i detyrës për ndihmësit ligjorë parashikohet në nenin 6/1 e në vijim të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Në lidhje me punën e kryer nga ndihmësi ligjor gjatë kohës që ka qenë i emëruar pranë një gjyqtari të caktuar, Gjykata nuk rezulton të ketë informacion, pasi ndihmësi ligjor kryente detyrat që i caktonte gjyqtari dhe për këtë nuk ka pasur një rregullim të caktuar ligjor, për mënyrën e ushtrimit dhe dokumentimit të detyrës së tyre. Gjykata me informacionin e përcjellë ka bashkëlidhur urdhrin nr. \*\*\*, datë 9.6.2015, ku z. Spartak Mitrushi është caktuar ndihmës ligjor pranë gjyqtarës L. S.”.*

ii. Komisioni i ka kërkuar<sup>93</sup> subjektit të rivlerësimit të depozitojë dokumentacion të përpiluar prej tij, si kërkime ligjore, hartime të opinioneve me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural, përgatitjen e ndonjë projektakti të nevojshëm për gjykimin, që të mbajë nënshkrimin e tij në cilësinë e konceptuesit, që të dokumentojnë ndihmën dhe këshillimin e tij dhënë për gjyqtarin relator, me të cilin ka punuar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

---

<sup>88</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.3.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>89</sup> Depozituar nga Gjykata Administrative e Apelit me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.3.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>90</sup> Dokumenti 4 – Çështja administrative nr. \*\*\*/\*\*\* akti, datë 16.7.2014 regjistrimi, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës N.L.K, kundër të paditurit Bashkia L; person i tretë SHSSH, Zyra Rajonale L. Dokumenti 5 – Çështja administrative nr. \*\*\* akti, datë 18.7.2014 regjistrimi, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës K.K, kundër të paditurit DRSSH T. Dokumenti 6 – Çështja administrative nr. \*\*\* akti, datë 26.5.2014 regjistrimi, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës B.R e N.LL, kundër të paditurve: 1. K.M. 2. M e P.P, T dhe T. 3. A.RR.SH. Dokumenti 7 – Çështja administrative nr.\*\*\* akti, datë 16.7.2014 regjistrimi, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës Drejtoria Rajonale Njësie e Tatimpaguesve të mëdhenj, kundër të paditurit DAT pranë DPT T, me person të tretë shoqërinë “\*\*\*\*” sh.a. Dokumenti 8 – Çështja administrative nr. \*\*\* akti, datë 24.7.2014 regjistrimi, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës S.Q, kundër të paditurit D. e P. e T. Rr.

<sup>91</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.7.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>92</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.7.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>93</sup> Me pyetësozin nr. 2, datë 6.9.2024, administruar në dosjen e Komisionit.



iii. Subjekti i rivlerësimit në përgjigjen e tij ka deklaruar<sup>94</sup>: “Gjatë periudhës 10-vjeçare që kam punuar në Gjykatën Administrative të Apelit, kam përpunuar, përgatitur, konceptuar dhe arsyetuar me qindra materiale, të cilat për arsye kohe dhe vendi nuk mund t’i paraqes të gjitha. Mënyra e punës ka qenë e ndryshme në varësi të gjyqtarit pranë të cilit na ngarkonin të punonim. Në raste se gjyqtari donte vetëm relacionin, unë si ndihmës vetëm atë bëja, ndërsa në rast se gjyqtari na kërkonte edhe arsyetimin e vendimit, e kam bërë sipas kërkesës së gjyqtarit. Për shkak se puna e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit ka qenë e parregulluar me ligj apo me një rregullore të veçantë, edhe nga ana e ndihmësit është bërë një punë sipas kërkesës së gjyqtarit për të cilin punonte”. Subjekti i rivlerësimit me përgjigjen ka bashkëlidhur disa materiale<sup>95</sup> të punës së tij, si printime të komunikimit me gjyqtarët relatorë të çështjeve ndër vite, relacione, vendime gjyqësore.

iv. Gjykata Administrative e Apelit informon<sup>96</sup> se nuk rezultojnë të dhëna negative për etikën në punë të subjektit të rivlerësimit, për periudhën gjatë së cilës ai ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor pranë kësaj Gjykate (13.7.2015 – 8.10.2016). Gjithashtu, nga përmbajtja e shkresës së sipërcituar rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Spartak Mitrushi, nuk ka qenë objekt i ndonjë procedimi disiplinor për shkelje discipline.

v. Pas kërkesës<sup>97</sup> së Komisionit, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar SPAK<sup>98</sup> informon se në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Spartak Mitrushi, nuk është regjistruar ndonjë procedim penal.

### **Rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës**

46. Shkolla e Magjistraturës ka dërguar<sup>99</sup> rezultatet e testimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, z. Spartak Mitrushi, ku nga verifikimi i tabelave të rezultateve konstatohet se në fazën e parë të testimit të aftësive profesionale “Testi elektronik” subjekti është vlerësuar me 46 pikë, nga 100 pikë të mundshme, ndërsa në fazën e dytë “Testi profesional” është vlerësuar me 92 pikë, shënuar 93 pikë në tabelë, nga 200 pikë të mundshme.

46.1 Nga verifikimi i regjistrimit të denoncimeve nuk rezulton që të jenë depozituar ankesa nga publiku në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit, z. Spartak Mitrushi.

### **Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale**

47. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u provua asnjë indicie apo element që cenon kriterin profesional të ndihmësit ligjor Spartak Mitrushi dhe, sipas parashikimeve të nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është

<sup>94</sup> Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, datë 6.9.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>95</sup> Materiale komunikuese të printuara nga posta elektronike e subjektit, depozituar me pyetësorin nr. 2, datë 6.9.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>96</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2023, depozituar në raportin profesional të subjektit, administruar nga Komisioni.

<sup>97</sup> Nr. \*\*\* prot., datë 13.3.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>98</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.3.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>99</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.5.2018, administruar në dosjen e Komisionit.

efektiv dhe eficient në masë të pranueshme dhe, përfundimisht, u vlerësua për kriterin profesional “i aftë”.

### **KONKLuzion Përfundimtar**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, si dhe pasi dëgjoi subjektin në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Spartak Mitrushi, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Spartak Mitrushi, ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesit ndërkombëtar, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më 14.11.2024.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Olsi KOMICI**  
**Kryesues**

**Brunilda BEKTESHI**  
**Relatore**

**Suela ZHEGU**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Albana Plaka*